

# PROSPEKT

**Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur**

**SIGAL**

**2024**

**Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL (në vijim “Fondi”)

**Shoqëria Administruese:** SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (në vijim “Shoqëria Administruese”), Themeluar më 21/01/2006 dhe e regjistruar në 31/01/2006 në regjistrin tregtar me NIPT K61423001P, me seli në adresën: Rruga "Ukraina e Lirë" pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë.

Organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL kryhet ekskluzivisht nga SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. dhe se Shoqëria Administruese është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij Prospekti.

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL - është fond pensioni me pjesëmarrje të hapur i themeluar në bazë të Vendimit datë 17.12.2010 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Administruese dhe miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 51, datë 30.03.2011. Monedha bazë e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL është Lekë.

Aktivet e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL janë tërësisht të ndara nga aktivet e Shoqërisë Administruese dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të Shoqërisë Administruese dhe se fondi nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit. Aktivet e Fondit janë tërësisht të ndara prej aktiveve të tjera të administruara nga Shoqëria Administruese. Aktivet e fondit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruese.

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është një fond pensioni me kontribute të përcaktuara. Skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara janë skema në të cilat kontributet që futen në fond janë të përcaktuara, ndërsa pagesat (përfitimet) janë në funksion të menaxhimit të tyre, ku rreziqet e skemës i mbajnë anëtarët.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj anëtarit të fondit nga veprimet ose mosveprimet e saj, nëse dokumentet ose informacioni i parashikuar në këtë prospekt përmbajnë të dhëna dhe informacione të pavërtetë ose të paplotë.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj anëtarit të fondit nga veprimet ose mosveprimet e saj, nëse dokumentat ose informacioni i parashikuar në këtë prospekt përmbajnë të dhëna dhe informacione të pavërtetë ose të paplotë.

**Prospekti i Parë:** Miratuar me Vendimin nr. 118, Datë 29.08.2012

Prospekti i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL nuk përfaqëson ftesë për anëtarësim në fond, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe rreziqet që mbart anëtarësimi në një fond pensioni privat.

**Data e Miratimit: 31 Mars 2023**

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Kemi kënaqësinë që nëpërmjet prospektit të sjellim tek ju informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL**.

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është miratuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. **SIGAL UNIQA INVEST** - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a është licencuar me vendim nr. 50 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e fondeve të pensionit privat dhe me vendim nr. 95, datë 28.04.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Në zbatim të nenit 100 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, është përgatitur prospekti me qëllim që anëtarët ekzistues dhe ata që dëshirojnë të marrin pjesë në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL**, të kenë informacionin e nevojshëm.

Shoqëria Administruese nëpërmjet prospektit, do të mundohet t’ju vijë në ndihmë duke ju dhënë informacionin e duhur mbi Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL**, kushtet për përfitim pensioni, shtrirjen e rrjetit të saj, Bankën Depozitare me të cilën bashkëpunon, fushat e investimit dhe mbi të gjitha për të siguruar një transparencë maksimale në marrëdhëniet me anëtarët. Shoqëria Administruese ka treguar kujdesin e nevojshëm që ky informacion të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marrëdhënie.

Prospekti, Raportet periodike dhe çdo informacion shtesë i kërkuar nga anëtari, do të vihen në dispozicion të Anëtarëve pa pagesë, pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese, në adresën Rr. Rruga "Ukraina e Lirë", Tiranë, pas një kërkesë me shkrim nëpërmjet postës elektronike dhe në faqen zyrtare të Shoqërisë.

Prospekti i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** do të jetë i disponueshëm edhe në degët e Grupit **SIGAL UNIQA**.

Të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me vlerën neto të aktiveve për kuotë, publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al).

Për çdo ankesë jeni të lutur të dërgoni me shkrim në adresën zyrtare postare të **SIGAL UNIQA INVEST** - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a ose në adresën elektronike: [info@fondisigal.com.al](mailto:info@fondisigal.com.al) Ankesat do të shqyrtohen nga strukturat përkatëse, dhe ju do të merrni përgjigje brenda 20 ditëve pune pas pranimit të ankesës.

Politika e investimit e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është miratuar nga Këshilli i Administrimit dhe është pjesë e këtij Prospekti. Politika e investimit është objekt rishikimi nga Shoqëria Administruese dhe ndryshimet e saj duhet të marrin miratimin e Këshillit të Administrimit përpara se të përfshihen në Prospektin e Fondit. Prospekti i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është miratuar me vendim nr.67, datë 31.03.2023 nga AMF. Shoqëria informon Anëtarët e Fondit për çdo ndryshim të prospektit brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti. Çdo ndryshim i rëndësishëm në prospekt do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.

Çdo anëtar i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit pa paguar komision transferimi, brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit të ndryshimeve të rëndësishme në Prospekt.

Duke shpresuar që jemi emri që ju i besoni të ardhmen tuaj,  
Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL**

## PËRMBAJTJE

I.	PËRKUFIZIME TË TERMAVE.....	4
II.	FONDI I PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR SIGAL.....	6
III.	FORMA LIGJORE E SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	7
IV.	PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	8
V.	STRUKTURA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	10
	Personeli Kyç.....	11
	Funksionet e deleguara .....	11
	Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve .....	11
VI.	KONTRIBUTET NË FONDIN E PENSIONIT .....	12
	Pagesa e kontributeve të anëtarëve në fondin e pensionit.....	12
	Llogaritja e Kuotave të anëtarëve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL .....	13
VII.	POLITIKA E INVESTIMEVE.....	13
	Objektivi i politikës së investimeve.....	13
	Profili i Investimit të Fondit.....	14
	Shpërndarja strategjike.....	14
	Investimet e lejuara .....	16
	Huamarrja për administrimin e Fondit.....	17
	Ndryshimet e politikës së investimeve të fondit .....	17
VIII.	PERFORMANCA E FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT .....	21
	Metodologjia e vlerësimit të aktiveve.....	21
	Të drejtat që burojnë nga anëtarësia në fond .....	24
IX.	TATIMI.....	24
	Trajtimi fiskal i fondit.....	24
	Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtari.....	24
	Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi.....	24
	Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtari .....	24
	Trajtimi fiskal i përfitimeve të marra nga anëtari .....	25
X.	PAGESA E PËRFITIMEVE.....	25
XI.	PAGESA E PENSIONIT .....	29
XII.	MËNYRA E PAGESËS SË PENSIONIT .....	30
XIII.	TËRHEQJA E PARAKOHSHME .....	31
XIV.	TRANSFERIMI I AKTIVEVE .....	32
XV.	TARIFAT DHE KOMISIONET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	32
XVI.	DEPOZITARI.....	33
	Roli dhe Funksionet e Depozitarit .....	33
	Detyrat e Depozitarit.....	34
	Konflikti i interesit të Depozitarit .....	34
XVII.	AUDITI I JASHTËM .....	35
XVIII.	BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDIT TË PENSIONIT .....	35
XIX.	LIKUIDIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	36
	Likuidimi vullnetar i shoqërisë administruese të fondeve të pensionit.....	36
	Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm .....	37
XX.	INFORMIMI I ANËTARËVE MBI VLERËN E AKTIVEVE DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE ..	38
	Ndryshimet e rëndësishme të prospektit .....	38
	Detyrimi për të publikuar prospektin .....	38

## I. PËRKUFIZIME TË TERMAVE

1. **“Autoriteti”** është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
2. **“Administrator”** është personi fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese në shoqërinë administruese.
3. **“Anëtar”** është individi, i cili i bashkohet fondit të pensionit në bazë të një kontrate anëtarësimi me shoqërinë administruese, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit.
4. **“Anëtar i mundshëm”** është individi, i cili ka të drejtë për t’u përfshirë në një fond pensioni.
5. **“Aktive”** janë tituj, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese apo të depozitarit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
6. **“Auditues i jashtëm”** është personi juridik në cilësinë e një shoqërie auditimi, me qëllim auditimin e pavarur të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara dhe ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.
7. **“Agjent i fondit të pensionit”** është personi juridik, i krijuar si institucion financiar dhe i regjistruar nga Autoriteti për të promovuar fondin e pensionit dhe për të ofruar kontrata anëtarësimi në fondin e pensionit në emër të shoqërisë administruese.
8. **“Depozitari”** është banka e licencuar nga Autoriteti të kryejë si veprimtari ruajtjen e aktiveve të fondit të pensionit privat, dhe detyrat dhe funksionet e përcaktuara në këtë ligj.
9. **“Fondi i pensionit privat”** është një grup i veçuar aktivesh pa personalitet juridik, i miratuar nga Autoriteti dhe i administruar nga shoqëria administruese, për llogari të anëtarëve të fondit në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Fondi i pensionit privat mund të jetë me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur.
10. **“Fond pensioni me pjesëmarrje të hapur”** është fondi i pensionit i krijuar nga shoqëria administruese, anëtar i të cilit mund të jetë çdo individ, përfshirë punëmarrësit e punëdhënësit, i cili zgjedh të kontribuojë në fondin e ofruar nga shoqëria administruese, pa krijuar një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur.
11. **“Instrumente financiare”** janë instrumentet financiare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.
12. **“Instrument i tregut të parasë”** është ai titull borxhi, i cili i jep pronarit të drejtën e pakushtëzuar për të marrë një shumë të përcaktuar fikse parash në një datë të përcaktuar dhe që emetohet me vlerë të skontuar në varësi të normës së interesit dhe kohës së mbetur deri në afatin e shlyerjes. Këtu përfshihen edhe bonot e thesarit, dëftesat tregtare dhe financiare, dëftesat e garantuara nga bankat dhe certifikatat e negociueshme të depozitës me afat fillestar shlyerjeje, jo më shumë se një vit, si edhe letra afatshkurtra të emetuara nga një njësi e organizuar për emetimin e letrave afatshkurtra.
13. **“Këshill i administrimit/mbikëqyrës”** është organ i shoqërisë administruese me përgjegjësi kryesore për administrimin dhe mbikëqyrjen, sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.
14. **“Komision transferimi”** është komisioni që anëtar i paguan shoqërisë administruese në momentin e transferimit të aktiveve nga një fond pensioni privat i një shoqërie administruese te një shoqëri tjetër administruese.
15. **“Komisioni vjetor i administrimit”** është tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat, e përllëgëruar në bazë të një përqindjeje vjetore sipas vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit.
16. **“Kthim nga investimi”** është rezultati që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi i kapitalit.
17. **“Kuotë pensioni”** është pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aktiveve të fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të aktiveve të fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të fondit të pensionit në çdo kohë është e barabartë me vlerën totale neto të aktiveve të këtij fondi pensioni.
18. **“Palë e lidhur”** është individi ose personi juridik që ka lidhje me shoqërinë administruese për shkak se është:
  - a) pjesëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose i punësuar nga shoqëria administruese;
  - b) pjesëtar i auditit të brendshëm të shoqërisë;
  - c) bashkëshorti/bashkëshortja, birësuesi dhe i birësuar ose një i afërm deri në gradë të dytë i një anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose auditit të brendshëm, i aksionarit apo punonjës i shoqërisë ose administratori i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrjes të çdo shoqërie tregtare, në të cilën shoqëria administruese ka një interes prej më shumë se 20%;

d) individi ose personi juridik që ka të drejtë të marrë vendime ose që ndikon në vendimet e shoqërisë në bazë të një kontrate apo mbi çdo bazë tjetër.

**19. “Përfitues”** është individi, i cili merr përfitime pensioni sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**20. “Periudhë e përfitimit të kontributeve”** (vesting period) konsiderohet periudha përpara se punëmarrësit t’i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi.

**21. “Persona kyç”** janë individët të cilët, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfaqësojnë shoqërinë administruese dhe ushtrojnë funksione drejtuese, përfshirë administratorin dhe anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë dhe në rastin e depozitarit drejtuesi i shërbimeve të depozitarit.

**22. “Personel kyç”** janë individët në poste të larta, të cilët janë përgjegjës për funksionet kyçe të shoqërisë administruese, ku përfshihen: drejtuesi i njësisë së administrimit të aktiveve/investimeve, drejtuesi i njësisë së administrimit të rrezikut, drejtuesi i njësisë së përputhshmërisë, drejtuesi i njësisë së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm dhe, në rastin e depozitarit, drejtuesi i auditimit të brendshëm, drejtuesi i administrimit të rrezikut dhe drejtuesi i përputhshmërisë.

**23. “Pjesëmarrja influencuese”** nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë i 10% apo më shumë i kapitalit ose të drejtave të votës apo zotërimi i pjesëmarrjes, e cila mundëson ushtrimin e influencës së konsiderueshme lidhur me administrimin e një shoqërie administruese të fondeve.

**24. “Platforma e Organizuar e Tregtimit (POT)”** është sistemi shumëpalësh, që nuk është treg i rregulluar apo platformë shumëpalëshe tregtimi, në të cilin lejohet ndërveprimi i interesave të shumëfishta të shitblerjes së palëve të treta sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

**25. “Platformë Shumëpalëshe Tregtimi (PSHT)”** është sistemi shumëpalësh i operuar nga një shoqëri komisionere ose një operator tregu sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

**26. “Shoqëri administruese e fondit të pensionit privat”**, (në vijim “shoqëri administruese”), është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe e licencuar nga Autoriteti për të administruar një ose disa fonde të pensionit privat.

**27. “Tituj të transferueshëm”** janë titujt sipas kuptimit të ligjit “Për tregjet e kapitalit”.

**28. “Transferim i aktiveve”** është transferimi i aktiveve nga një fond pensioni te një fond tjetër pensioni.

**29. “Treg i rregulluar”** është sistemi shumëpalësh i operuar dhe/ose administruar nga një operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumëfishta të shitblerjes së instrumenteve financiare të palëve të treta, sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

**30. “Vlera neto e aktiveve për kuotë”** është vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit e pjesëtuar me numrin e kuotave në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

**31. “Vlera neto e aktiveve”** është vlera e agreguar e aktiveve të fondit të pensionit pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve në momentin e llogaritjes.

## II. FONDI I PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR SIGAL

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL është një grup aktivesh në pronësi të anëtarëve të tij, në emër dhe në përfitim të të cilëve është hapur një llogari dhe që kanë të drejtë përfitimi në të ardhmen në bazë të kontratës së anëtarësimit që është lidhur.

Në këtë Fond mund të anëtarësohet çdo person individ apo punëmarrës, i cili me pëlqimin e tij (ose të përfaqësuesit të tij ligjor) bëhet anëtar i fondit të pensionit dhe lidh kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese për të përfituar shërbimet e fondit të pensionit.

Anëtarësimi në fond bëhet nëpërmjet:

- a) nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit individual, kur anëtari i fondit është individ;
- b) nënshkrimit nga punëmarrësi të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes në fondin e pensionit të zgjedhur nga punëdhënësi.

Pjesë përbërëse e kontratës së pensionit është edhe formulari standard i aplikimit, i cili përmban deklaratën personale të anëtarit. Duke e nënshkruar këtë deklaratë anëtari pranon kushtet e kontratës, si dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin.

Kontrata e anëtarësimit ose deklarata e pranimit të pjesëmarrjes nënshkruhet vetëm pasi anëtari i mundshëm është njohur me prospektin e fondit.

Me nënshkrimin e kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, shoqëria administruese detyrohet të regjistrojë anëtarin në regjistrin e anëtarëve, të hapë një llogari personale në emër të anëtarit të fondit dhe pas kryerjes së pagesës në llogarinë e fondit të bëjë konvertimin e kësaj të fundit në kuota, ta pajisë anëtarin me kredencialet përkatëse, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera ligjore të nevojshme për administrimin e fondit të pensionit.

Përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit shoqëria administruese është e detyruar të informojë anëtarin e fondit për të gjitha tarifatat që do t'i ngarkohen, opsionet e pagesës së pensionit me lindjen e së drejtës për pension, kushtet kur lind e drejtat e pensionit, kushtet për tërheqjen nga fondi apo transferimin e aktiveve, rreziqet e investimit, si dhe mënyrat dhe afatet për informimin e anëtarit të fondit të pensionit.

### Të Dhëna Historike

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL veprimtarinë e tij e ka filluar në 31.03.2013, datë në të cilën ka publikuar dhe çmimin e kuotës për herë të parë .

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** në fund të vitit 2023 zotëron:


-Vlera Neto e Aktiveve të fondit	: 2,782,453,372.87 lekë
-Numri i Anëtarëve	: 11,244

Struktura e portofolit të investimeve bazuar në Politikën e investimeve, në shpërndarjen strategjike të saj si dhe në kufijtë e lejuar të investimeve në fund të vitit 2023 është:

Tituj të Qeverisë Shqiptare	2,718,570,174.19	97.46%
Depozita me afat	35,171,835.62	1.26%
Mjete monetare	35,709,042.28	1.28%

Në bazë të politikës së ndjekur, kthimi neto nga investimi i aktiveve të anëtarëve në vlerë dhe në përqindje, paraqitet si më poshtë:

Viti	Kthimi Vjetor Neto (në lekë)	Në %
2013	7,131,748.94	4.39
2014	11,869,976.78	4.81
2015	16,608,121.00	4.44
2016	23,575,087.00	4.34
2017	30,585,148.00	4.12
2018	30,865,676.00	3.24
2019	45,459,162.00	3.43
2020	47,064,406.00	3.26
2021	58,450,371.00	3.37
2022	74,182,667.75	3.29
2023	91,755,916.52	3.52



Shënim: Niveli i të ardhurave neto nuk është i garantuar

Tarifa e vetme vjetore e mbajtur nga aktivet e fondit, është komisioni vjetor i administrimit i cili për periudhën 2023 ka qenë në nivelin 2.2 %.

Misioni i Shoqërisë Administruese konsiston në administrimin e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, për mbledhjen dhe investimin e kontributeve të anëtarëve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, në përputhje me Ligjin nr. 76/2023, “Për Fondet e Pensionit Privat”.

### III. FORMA LIGJORE E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe të aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28.04.2022, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. është një shoqëri aksionare me:

Seli: Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane  
(Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë  
Numri Unik i Identifikimit: K61423001P

Data e themelimit: 21.01.2006

Data e regjistrimit: 31.01.2006



Shuma e kapitalit aksionar të shoqërisë administruese është shuma e parave të cilat aksionarët kanë investuar në shoqërinë e tyre për mbulim të shpenzimeve apo humbjeve të kompanisë.

Vlera për kapitalin e shlyer është 57,028,800 lekë.

Shoqëria administruese ka nën administrim:

- Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, licencuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO, licencuar me vendim nr. 251 dhe datë 20.12.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Fondin e Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike **SIGAL INVEST** licencuar me vendim nr. 17 datë 28.02.2023 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Shoqëria Administruese mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ligjit nr.76/2023, “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria Administruese gjatë punës së saj vepron me ndershmëri, kujdesin e duhur e profesionalizëm, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira.

## IV. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

**Shoqëria administruese ka dy aksionarë:**

- |  |                   |
|--|-------------------|
| - Shoqëria e Sigurimeve “SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. | 51% të aksioneve  |
| - Z. Avni PONARI   | 49 % të aksioneve |

**Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:**

### I. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

1. **Edvin Hoxhaj**, Shoqëria “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.
2. **Avni Ponari**, CEO SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

### II. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

- |                           |         |
|---------------------------|---------|
| 1. <b>Adrian Totokoçi</b> | Kryetar |
| 2. <b>Abdyl Sarja</b>     | Anëtar  |
| 3. <b>Edvin Hoxhaj</b>    | Anëtar  |
| 4. <b>Klement Mersini</b> | Anëtar  |
| 5. <b>Elvis Ponari</b>    | Anëtar  |

**Këshilli i Administrimit** ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikatat financiare dhe politikatat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

**Z.Adrian Totokoci**, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.

Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

- Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri.
- Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri,
- Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

Z. Adrian Totokoci nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Abdyl Sarja**, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.

Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.

Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006).

Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Edvin Hoxhaj**, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti.

Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. (që nga viti 2008); anëtar i Bordit Këshillimor të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., Kosovë (që nga viti 2012) dhe anëtar i Bordit Këshillimor të UNIQA Life a.d. Shkup (që nga viti 2014) Maqedonia e Veriut.

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Klement Mersini** ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.

Aktualisht, Z.Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen

dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e aktiveve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z. Elvis Ponari** është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group Austria” sh.a.. Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAZ. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja.


Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

## V. STRUKTURA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL administrohet nga SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Për kryerjen e misionit të saj konform dispozitave ligjore, shoqëria administruese ka krijuar strukturat e saj. Krijimi i strukturës organizative mbështetet në funksionet që ajo ka sipas statutit dhe licencës së marrë si dhe të nevojës për përmbushjen e misionit të saj.

**Struktura Organizative paraqitet sipas një ORGANIGRAME të përshkruar në vijim:**



Administratori i Shoqërisë Administruese është **Z. Elvis Ponari**, i emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe i miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, deri më 20/06/2026, me të drejtë rinovimi.

Administratori i shoqërisë administruese është person fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese:

- përfaqëson shoqërinë administruese
- organizon dhe menaxhon veprimtarinë e shoqërisë
- përgatit rregulloret e përgjithshme si dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë administruese sipas ligjit në fuqi dhe i propozon për miratim këshillit të administrimit

- vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit dhe kryen aktivitete të ndryshme të përcaktuara në ligj

Për funksionimin e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, Shoqëria Administruese ka miratuar dhe stafin zbatues, të përqendruar në Departamente: Departamenti i Përfitimeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Kontributeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Menaxhimit të Portofolit, Departamenti i Administrimit të Rrezikut, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Shitjeve dhe Departamenti Ligjor, Burime njerëzore & Përputhshmërisë.

Shoqëria administruese ka krijuar edhe strukturat e veta të përbëra nga Degët në Korçë dhe Shkodër.

Gjithashtu, shoqëria administruese përfaqësohet nga degët dhe agjencitë e kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. bazuar në kontratën e shërbimit midis tyre.

## Personeli Kyç

Z. Elvis PONARI – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Portofolit

Z. Fation CEKA – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Rrezikut

Znj. Livja GJIKA – Drejtoreshë, Drejtorja Ligjore, Burime Njerëzore, Përputhshmërisë dhe PPP & Financimit të Terrorizmit.

Asnjë nga personat e Personelit Kyç nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

## Funksionet e deleguara

Shoqëria administruese ka deleguar disa funksione bazuar në një marrëveshje me kompaninë mëmë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. Kompania SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. aktivitetin e saj kryesor e ushtron në fushën e sigurimeve, dëmeve dhe ri-sigurimeve, në përputhje me ligjin “Për veprimtaritë e sigurimit, të ri-sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe ri-sigurime” si dhe çdo objekt tjetër të lejuar nga legjislacioni dhe që nuk vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve, si më poshtë:

- Shërbimet e marketingut dhe reklamës Shërbimet e Informacionit e Teknologjisë Shërbimet e Statistikë –Aktuaristikë
- Shërbimet e Auditit të brendshëm dhe të kontrollit të brendshëm
- Konsulencë ligjore
- Kanalet dhe pikat për shitjet e produkteve
- Shërbimet e trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve të specialistëve

Shoqëria administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarëvajtjen e çdo funksioni të deleguar.

## Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve

Shoqëria administruese vendos të delegojë disa funksione të aktivitetit të saj në palë të treta duke vënë në plan të parë interesin më të mirë të anëtarëve, kjo edhe në rastin kur palë e tretë është shoqëria mëmë.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të:

- ndërmarrë masat e nevojshme për identifikimin e konflikteve të interesit;
- hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për të shmangur konfliktet e identifikuara të interesit;
- njoftojë shoqërinë administruese për çdo konflikt interesash që nuk mund të shmanget.

Për çdo funksion të deleguar informohet Autoriteti i Mbikëqytjes Financiare.

## VI. KONTRIBUTET NË FONDIN E PENSIONIT

Kontributet e anëtarëve përfaqësojnë pagesat në para që kryejnë individët anëtarë të Fondit, punëdhënësi ose çdo person i tretë në emër të tyre në Lekë.

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është një fond pensioni me kontribute të përcaktuara. Skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara janë skema në të cilat kontributet që futen në fond janë të përcaktuara, ndërsa pagesat (përfitimet) janë në funksion të menaxhimit të tyre, ku rreziqet e skemës i mbajnë anëtarët.

Në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** të drejtën për t'u anëtarësuar e kanë të gjithë personat, pavarësisht nga mosha, vendndodhja dhe punësimi.

Kontributi minimal në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** është 1,000 lekë.

### Pagesa e kontributeve të anëtarëve në fondin e pensionit

Kontributet për pension privat i paguajnë individët anëtarë të Fondit, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë në emër të tyre në Lekë.

Kontributi për pension mund të paguhet në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Por gjithashtu mund të paguhet edhe si shumë e menjëhershme. Mënyra e pagesës së kontributit mund të bëhet cash, me transfertë bankare, direct debit dhe e-banking.

**Punëdhënësi** mund të paguajë kontributin për pension në tre mënyra:

- a. Nëpërmjet llogarisë bankare, si një shumë të menjëhershme të shoqëruar me listën e punonjësve dhe masën e kontributit mujor për secilin punonjës, kur kontributet përballohen nga punëdhënësi.
- b. Nëpërmjet llogarisë bankare, duke dhënë të specifikuar dy shuma të ndara sipas pagesave që kryejnë (punëdhënës dhe punëmarrës) të shoqëruar me listën emërore, kur pjesëmarrja është e përbashkët midis dy palëve.
- c. Zbritje automatike nga paga e masës së kontributit të punëmarrësit, sipas marrëveshjes midis palëve (punëdhënës-punëmarrës).

Punëdhënësi mund të përcaktojë një periudhë përpara se punëmarrësit t'i lindë e drejta për të përfituar kontributet e derdhura nga punëdhënësi në favor të tij. Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet.

Nëse një anëtar/e përkohësisht ose përfundimisht ndërpret pagesën e kontributit, ai/ajo do të vazhdojë të mbetet anëtar/e në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** duke ruajtur të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë.

Shoqëria administruese do të informojë çdo anëtar për gjendjen e aktiveve të tij në intervale të rregullta kohore të paktën një herë në vit nëpërmjet dokumentit “Vërtetimi për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit” dhe sa herë të kërkohet nga anëtari.

Vërtetimi për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit përmban: të dhënat e anëtarit të fondit të pensionit, vlerën neto të aktiveve të akumuluar, kthimin nga investimi për periudhën 12-mujore, informacion për kontributet e derdhura nga anëtari ose punëdhënësi në emër të anëtarit gjatë 12 muajve të fundit dhe një detajim të kostove ose tarifave të zbritura nga shoqëria administruese gjatë 12 muajve.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aktiveve neto për çdo anëtar. Informimi i anëtarëve do të bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet faqes së internetit: [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al) dhe një herë në vit me shkresë zyrtare.

Të gjithë anëtarët e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL**, pajisen që në momentin e nënshkrimit të kontratës me kartën e anëtarësimit ku nëpërmjet numrit të sigurimit dhe fjalëkalimit kanë të drejtë të shohin llogarinë e tyre në çdo moment në faqen zyrtare.

Pagesat e kontributeve për pension bëhen në llogarinë bankare të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** në bankën depozitare Banka Amerikane e Investimeve sh.a. në llogarinë: **IBAN: AL28 2101 1012 0000 0000 0174 5960**

## Llogaritja e Kuotave të anëtarëve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL

Çdo anëtar i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur **SIGAL** ka një kuotë pensioni, e cila përfaqëson pjesën e pronësisë në fondin e pensionit. Shoqëria administruese konverton në kuotë pensioni, sipas çmimit të kuotës një ditë përpara pagesës së kontributit, kontributet e investuara në fond dhe aktivet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilin nga aktivet e Fondit.

### Shembull i blerjes së një kuote pensioni

- Kontributi: **5,000.00 Lekë**
- Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit : **1,000.00 Lekë**
- Numri i kuotave të anëtarit në Fond: **5,000.00 Lekë / 1,000.00 Lekë = 5 kuota**

Ky transaksion regjistrohet në llogarinë individuale të anëtarit të Fondit.

Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga **1,000.00 Lekë** në **1,100.00 Lekë**, vlera e aktiveve të anëtarit në Fond do të jetë **1,100.00 Lekë x 5 kuota = 5,500.00 Lekë**.

## VII. POLITIKA E INVESTIMEVE

### Objektivi i politikës së investimeve

Objektivi i investimit është:

- Investimi në tituj të Qeverisë shqiptare me afat të gjatë gjë e cila maksimizon kthimin afatgjatë të investimit.
- Investimi në tituj të Qeverisë Shqiptare e cila siguron normë më të lartë kthimi dhe maksimizim të fitimit të Fondit të Pensionit.
- Administrim i kujdesshëm dhe konservator i rrezikut të investimit. Për këtë arsye objektivi i investimit është investimi në instrumente financiare me rrezik sa më të ulët.
- Portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

Investimi bëhet në përputhje me disa parime:

- Parimi i Sigurisë – Aktivet e Fondit investohen në instrumente me kredibilitet të lartë siç janë titujt qeveritarë;
- Parimi i Diversifikimit të Portofolit – Aktivet e Fondit investohen në instrumente të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme;

- Parimi i ruajtjes së nivelit të mjaftueshëm të likuiditetit – duke siguruar që në strukturën e portofolit të Fondit të ketë instrumente likuide, ruajtja e një niveli të mjaftueshëm likuiditeti për t’iu përgjigjur të gjitha detyrimeve të pensioneve në mënyrën e duhur dhe në kohë.

## Profili i Investimit të Fondit

Duke u nisur nga fakti që detyrimet e Fondit janë afatgjata, prirja e profilit të investimit do të jetë afatgjatë, si më poshtë:

**Horizonti i Investimit:** Afatgjatë

**Niveli i Tolerancës ndaj Rrezikut të Investimit:** Konservator

**Miksi i Portofolit/Preferenca e Investimit:** Kthimi optimal

**Objektivi i Investimit:** Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe likuiditetit për të siguruar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës së pensionit.

**Strategjia e Investimit:** Të gjitha investimet do të kryhen duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar për shkak të kohës së largët të daljes në pension.

## Shpërndarja strategjike

Aktivitetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij.

Instrumentet në përbërjen e portofolit janë:

- Tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme;
- Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre;
- Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

## Shpërndarja strategjike e aktiveve për Fondin paraqitet si më poshtë:

Lloji i Aktiveve	Shpërndarja strategjike Target
Tituj të Qeverisë Shqiptare	99 % +/-1%
Mjete Monetare, ekuivalentë të tyre & Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë	1 % +/-1 %

Për propozimin e politikave të investimit dhe ndjekjen e zbatimit të tyre, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.76/2023 për “Për Fondet e Pensionit Privat”, është ngritur Komiteti i Investimit me përbërje:

1. **Z. Elvis Ponari**, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese
2. **Z. Klement Mersini**, Drejtor i Departamentit të Financës në Shoqërinë e Sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.
3. **Z. Blodin Çuçi**, Administrator i Caesar Investment Advisory Services
4. **Z. Naim Hasa**, Ekspert në fushën e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve Private

**Komiteti i Investimit** mbledhet jo më pak se 4 herë në vit, për të hartuar politikën e investimit, shpërndarjen e aktiveve si dhe ndryshimet e tyre dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Administrimit. Këto politika

mbështeten mbi analiza cilësore dhe sasiore të tregjeve të kapitalit, rrezikut, si dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit, sipas ligjit dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Komiteti i Investimit merr vendime lidhur me investimet që kryhen dhe do të kryhen për llogari të Fondit të Pensionit.

Për ndjekjen e investimeve, janë ngritur: Departamenti i Administrimit të Rrezikut dhe Departamenti i Menaxhimit të Portofolit:

**Menaxheri i Rrezikut** - kryen identifikimin, matjen dhe kontrollin si sasior dhe cilësor të rreziqeve dhe bën menaxhimin dhe raportimin e tyre. Ai bashkëpunon me Menaxherin e Portofolit në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet në përputhje me rrezikun ekzistues të portofolit dhe jep rekomandime për mbajtjen e niveleve të përshtatshme të rrezikut brenda kufijve të përcaktuar. Menaxheri i Rrezikut kryen provat e rezistencës në kushte normale dhe në kushte të stresuara të tregut me qëllim monitorimin e ecurisë së fondit dhe treguesit të likuiditetit.

**Menaxher i portofolit** - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit, studimin e tregut dhe zhvillimin e analizave të tij personale në lidhje me aftësitë paguese të emetuesit, është përgjegjës për administrimin e aktiveve të fondeve të pensionit në përputhje me ligjin, prospektin dhe rregulloret. Ai është përgjegjës për ekzekutimin e politikave të investimit në përputhje me kufijtë ligjorë dhe me vendimet strategjike të Këshillit të Administrimit.

Departamenti i administrimit të rrezikut dhe ai i menaxhimit të portofolit luajnë role thelbësore në sigurimin e suksesit të investimeve përmes identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve, vendimmarrjes së informuar dhe monitorimit të vazhdueshëm të performancës së portofolit.

Departamenti i administrimit të rrezikut dhe departamenti i menaxhimit të portofolit janë përgjegjës për investimet e kryera për disa arsye kryesore:

### **Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut**

*Administrimi i rrezikut:* Ky departament është i ngarkuar me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me investimet. Kjo përfshin analizën e rreziqeve financiare, operacionale, dhe të tregut, që mund të ndikojnë në kthimin e investimeve.

*Menaxhimi i portofolit:* Departamenti i menaxhimit të portofolit duhet të marrë parasysh rreziqet e identifikuar për të ndërtuar dhe menaxhuar një portofol investimesh që ofron një ekuilibër optimal midis rrezikut dhe kthimit.

### **Vendimmarrja Strategjike dhe Alokimi i Aktiveve:**

*Administrimi i rrezikut:* Ky departament ndihmon në zhvillimin e strategjive të investimit që minimizojnë rreziqet dhe maksimizojnë përfitimet. Ata rekomandojnë diversifikimin e aktiveve dhe përdorimin e instrumenteve të mbrojtjes nga rreziqet.

*Menaxhimi i portofolit:* Ky departament kryen vendimmarrjen strategjike për alokimin e aktiveve bazuar në analizat e rrezikut dhe qëllimet financiare të anëtarit. Ata përcaktojnë përqindjet e investimeve në instrumente të ndryshme financiare (si aksione, obligacione, dhe aktive të tjera) për të arritur një portofol të balancuar.

### **Monitorimi dhe Rregullimi i Performancës:**

*Administrimi i rrezikut:* Ky departament monitoron vazhdimisht rreziqet që mund të prekin portofolin dhe sugjeron masa për t'i menaxhuar ato. Ata përdorin modele dhe analiza statistikore për të parashikuar dhe kontrolluar ndikimet e ndryshimeve në treg.

*Menaxhimi i portofolit:* Ata monitorojnë performancën e investimeve dhe bëjnë rregullime të nevojshme për të siguruar se portofoli përputhet me objektivat e anëtarit dhe qëndron brenda niveleve të pranueshme të rrezikut.



## **Zbatimi i Politikave dhe Rregulloreve:**

*Administrimi i rrezikut:* Sigurohet që të gjitha investimet dhe strategjitë e menaxhimit të rrezikut janë në përputhje me rregulloret dhe politikat e brendshme dhe të jashtme.

*Menaxhimi i portofolit:* Sigurohet që portofoli është i përputhshëm me politikat e investimit dhe rregulloret e sektorit financiar, duke ndjekur praktikatat më të mira dhe standardet e industrisë.

**Komiteti i Investimit** në bashkëpunim me **Departamentin e Administrimit të Rrezikut** dhe **Departamentin e Menaxhimit të Portofolit** janë përgjegjës për investimet e kryera.

## **Investimet e lejuara**

Bazuar në kërkesat ligjore dhe rregullatore për investimin e aktiveve sipas kërkesave të Nenit 90 të ligjit 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, aktiveve e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL për vitin 2023 janë investuar në obligacione qeveritare të emetuara dhe të garantuara nga Republika e Shqipërisë.

Edhe në vitet në vazhdim aktivet e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL sipas politikës së investimit do të investohen 100% në tituj qeveritarë të emtuar dhe të garantuar nga Republika e Shqipërisë. Bazuar në kërkesat ligjore dhe rregullatore për investimin e aktiveve sipas kërkesave të nenit 90 të ligjit 76/2023 aktivet e një Fondi Pensioni mund të investohen vetëm në:

- a) tituj borxhi të emetuara ose të garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- b) tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;
- c) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar për tregtim në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend të OECD-së, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në kontratën ose prospektin e fondit të pensionit;
- ç) mjete monetare dhe depozita në banka të licencuara në Republikën e Shqipërisë dhe/ose vendet e OECD-së;
- d) tituj borxhi të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare që nuk janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;
- dh) instrumente financiare derivative vetëm për rastet e mbrojtjes nga rreziku i investimit. Në rast se shoqëria administruese vendos të përdorë derivative, duhet të ketë politikë ose procedurë të brendshme, të cilat përcaktojnë kufizime në lidhje me rreziqet që shoqërojnë përdorimin e tyre. Rreziqet në lidhje me përdorimin e këtyre instrumenteve duhet të jenë pasqyruar në prospektin e fondit të pensionit;
- e) aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, me përjashtim të fondeve të investimeve alternative;
- ë) kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, me kusht që:
  - i. këto sipërmarrje të mos administrohen nga e njëjta shoqëri që administron fondin e pensionit;
  - ii. këto sipërmarrje të jenë të licencuara, në zbatim të ligjeve që parashikojnë se janë objekt i mbikëqyrjes, që konsiderohet nga autoriteti si mbikëqyrje e njëjtë me atë që parashikohet në legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe që të jetë garantuar mjaftueshëm bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve;
  - iii. niveli i mbrojtjes për pjesëmarrësit në sipërmarrjet e tjera të jetë i barasvlershëm me atë që parashikohet për pjesëmarrësit në sipërmarrjen e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti me rregullat për veçimin e aktiveve, huamarrjen, huadhënien dhe shitjen e pambuluar të titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë, që janë të barasvlershme me kërkesat përkatëse në këtë ligj;
  - iv. veprimtaria e sipërmarrjeve të tjera të raportohet në raportet vjetore dhe të ndërmjetme dhe në pasqyrat financiare për të mundësuar vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe veprimtarisë gjatë periudhës së raportimit.

### **Kufizimet mbi ekspozimin**

- Aktivitet e një fondi pensioni duhet të përmbushin parashikimet e mëposhtme lidhur me kufizimin e ekspozimit:
- a) nuk investon më tepër se 5% të vlerës së aktiveve të fondit në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara nga një emetues i vetëm, me përjashtim të rastit kur:
    - i. limiti i 5% mund të rritet në 10%, por në këtë rast vlera totale e titujve dhe e instrumenteve të tregut të parasë të disa emetuesve, në të cilat fondi i pensionit investon më tepër se 5% të vlerës së aktiveve, nuk tejkalon 40% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit;
  - b) nuk investon më tepër se 2% të vlerës së aktiveve të fondit, të emetuara nga një emetues i vetëm në tituj borxhi, të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Në total vlera totale e titujve të borxhit, të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, nuk tejkalon 5% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit;
  - c) nuk investon më shumë se 20% të vlerës së aktiveve të fondit në depozita pranë një subjekti të vetëm;
  - ç) në përjashtim nga shkronja “a” e kësaj pike, nëse titujt e borxhit emetohen ose garantohen nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, mund të investojnë deri në 100% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit në këtë emetues të vetëm;
  - d) në përjashtim nga shkronja “a” e kësaj pike, nëse titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parasë emetohen ose garantohen nga qeveria qendrore e një vendi anëtar i OECD-së, mund të investojnë deri në 30% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit në këtë emetues të vetëm;
  - dh) në rastin e parashikuar nga shkronja “d” e kësaj pike, fondi i pensionit mund të investojë më shumë se 30% të vlerës së aktiveve të fondit në këta tituj të emetuar nga një subjekt i vetëm, me kusht që:
    - i. shoqëria administruese, përpara se të bëhet ky investim, të konsultohet me depozitarin dhe në bazë të kësaj të vlerësojë nëse emetuesi i këtyre titujve është i përshtatshëm në përputhje me objektivat e investimit të fondit në fjalë;
    - ii. jo më shumë se 30% e vlerës së aktiveve të fondit të konsistojë në tituj të një emetimi të vetëm;
    - iii. aktivet e fondit të pensionit të përfshijnë këta tituj të emetuar nga i njëjti emetues apo një emetues tjetër me të paktën gjashtë emetime të ndryshme me numra të ndryshëm ndërkombëtarë të identifikimit të titujve (ISIN) ose të barasvlershëm të tyre; dhe iv. të jetë pasqyruar ky fakt në prospektin e fondit të pensionit;
  - e) në lidhje me investimin në obligacionet e mbuluara, kufizimi prej 10% në zbatim të shkronjës “a” të kësaj pike, rritet në 25% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit;
  - ë) nuk investon më shumë se 10% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit në aksione ose kuota të një sipërmarrjeje të vetme të investimeve kolektive me ofertë publike, me kusht që tërësia e ekspozimeve të mos tejkalojë 30%, nëse këto sipërmarrje nuk janë klasifikuar si SIKTT në Republikën e Shqipërisë ose (UCITS) në vendet e Bashkimit Evropian.
2. Nëse investimi është në aksione ose kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, prospekti i fondit të pensionit duhet të vendosë qartë tarifën e administrimit që aplikohet për sipërmarrjet ku do të investojë. Gjithashtu, pasqyrat vjetore të audituara duhet të përmbajnë informacion të qartë mbi përqindjet maksimale të tarifave të administrimit që i ngarkohen fondit të pensionit nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, ku dëshiron të investojë.
3. Aktivitet e fondit të pensionit nuk duhet të investohen në:
- a) metale të çmuara apo të ekspozohen ndaj bursave të mallrave të tjerë;
  - b) në aktive fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si: antika, punime arti, mjete motorike, etj.

### **Huamarrja për administrimin e Fondit.**

Shoqëria Administruese nuk ka aplikuar dhe nuk aplikon marrjen e instrumenteve ose transaksioneve të tjera ligjore si kredia apo hua për administrimin e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL. Shoqëria Administruese mbështetet në politikat dhe procedurat e saj për një menaxhim sa më të mirë të likuiditetit me qëllim që të mos lindë nevoja për huamarrje.

### **Ndryshimet e politikës së investimeve të fondit**

Politika e investimit të Fondit është miratuar nga Këshilli i Administrimit dhe është pjesë e këtij Prospekti. Politika e investimit trajtohet si një dokument i cili rishikohet në baza të vazhdueshme. Ndryshimet në kuadrin

ligjor dhe ndryshime të mëdha në detyrimet e Fondit dhe në profilin e kthimit dhe të rrezikut janë kusht për rishikim të politikës së investimit.

Politika e investimit është objekt rishikimi nga Shoqëria Administruese dhe ndryshimet e saj duhet të marrin miratimin e Këshillit të Administrimit përpara se të përfshihen në Prospektin e Fondit i cili është objekt miratimi nga Autoriteti i mbikëqyrjes Financiare.

Ndryshimet në politikën e investimeve të fondit bëhen në përputhje me kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Shoqëria Administruese brenda 10 ditëve nga miratimi nga Autoriteti, informon anëtarët e fondit për çdo ndryshim të politikës së investimit të aktiveve të Fondit.

Shoqëria Administruese dërgon njoftim me postë normale ose me postë elektronike të gjithë anëtarëve të fondit për ndryshimet e rëndësishme në prospekt.

Ndryshimet e rëndësishme të prospektit publikohen edhe në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese.

## ADMINISTRIMI I RREZIQEVE

Investimi në fond detyrimisht përfshin sipërmarrjen e rrezikut. Nëpërmjet përcaktimit rigoroz të procedurave të administrimit të rrezikut dhe sistemit të brendshëm, shoqëria administruese është në gjendje të bëjë identifikimin, matjen si dhe administrimin e rrezikut, sidomos për sa i përket rrezikut të investimit, tregut, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional dhe rrezikut të përputhshmërisë.

**Rreziku i investimit** është rrezikut më i rëndësishëm që mbajnë anëtarët e fondit me kontribute të përcaktuara.

Investimi në Fond detyrimisht përfshin sipërmarrjen e rrezikut nga anëtari. Të gjitha llojet e investimit ofrojnë një balancë midis rrezikut dhe kthimit potencial. Përgjithësisht rreziku nga investimi në tregjet e kapitalit lidhet me mundësinë që kthimi të jetë i pakënaqshëm ose negativ. Balanca rrezik-kthim ndryshon sipas llojit të investimit, entitetit që e emeton atë, situatës së përgjithshme ekonomike të vendit ku bëhet investimi, si dhe gjendjes dhe cikleve të tregjeve financiare. Rregulli i përgjithshëm presupozon që për të patur një kthim më të lartë duhet ndër marrë një rrezik më i lartë. Rrjedhimisht investimet me rrezik më të ulët kanë edhe kthim më të ulët.

Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë, përgjegjëse për evidentimin, vlerësimin dhe administrimin e rreziqeve që shoqërojnë investimet e kryera në emër të Fondit, me anë të kontrollit të të gjitha transaksioneve të kryera. Veprimtaria e kësaj njësie së bashku me metodologjinë e administrimit të rrezikut janë të parashikuara në rregulloret dhe procedurat e brendshme të shoqërisë administruese. Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, për shkak të natyrës së investimeve të cilat synojnë kryesisht tituj borxhi me vlerë të emetuara ose garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, ka një profil rreziku të lidhur ngushtë me rrezikun e qeverisë shqiptare.

Ky rrezik është në qendër të vëmendjes së Shoqërisë Administruese, pasi norma e kthimit nga investimi është përcaktuesi kryesor i qëllimit të anëtarësimit në fondin e pensionit. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për të arritur një normë kthimi nga investimi sa më të lartë:

- Nëpërmjet përcaktimit dhe përzgjedhjes sa më të përshtatshme të afateve të investimit të aktiveve.
- Duke i kushtuar rëndësi procesit dhe efikasitetit të investimit, me qëllim që të këtë përfitim sa më maksimali nga investimet dhe anëtarët e tij, duke rritur pritshmërinë e kthimit dhe ulur sa më shumë rrezikun.
- Duke mbajtur nën kontroll rrezikun e investimit si dhe duke zbatuar kufijtë sasiore që vendosin aktet normative.

**Rreziku i tregut** është rreziku i uljes së vlerës së kuotës së fondit që vjen si pasojë e ndryshimit (rënies) të vlerës së investimeve që përbëjnë fondin. Ndryshimi i vlerës së investimeve është rezultat i faktorëve të ndryshëm të tregut si norma e interesit dhe kursi i këmbimit. Duke qenë se Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL përbëhet kryesisht nga investime në tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga

qeveria e Republikës së Shqipërisë, rreziku i tregut për këtë fond përcaktohet nga faktorë lokalë të tregut që në këtë rast është vetëm norma e interesit.

Llojet e rrezikut të tregut janë:

- *Rreziku i Normës së interesit* - Ndryshimi i normave të interesit të titujve të borxhit të emetuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën LEKË, ndikon në ndryshimin e çmimit të tregut të këtyre instrumenteve dhe për rrjedhojë ndikon drejtpërsëdrejti në ndryshimin e vlerës neto të aktiveve dhe kthimin nga investimi në fond.
- *Rreziku i Kursit të këmbimit* - Fondi nuk është subjekt i rrezikut të kursit të këmbimit pasi Fondi mbahet në monedhën Lekë dhe investimet bëhen në tregun vendas.

Në përgjithësi, nëse fondi do investonte aktive në një monedhë të ndryshme nga monedha e Fondit (Lekë) luhatshmëria e pafavorshme e kursit të këmbimit do të rezultonte në ndryshim të vlerës së aktiveve të kuotuar në monedhë të ndryshme nga Lekë.

- *Rreziku i Inflacionit* - Rreziku i inflacionit përfaqëson mundësinë që vlera reale e investimit të rezultojë më e ulët për shkak të rritjes së çmimeve.

Shoqëria administruese do të kryejë një kontroll cilësor dhe sasior të rrezikut të tregut në mënyrë të vazhdueshme, që të zvogëlojë maksimalisht pasojat negative të tij mbi aktivet e Fondit të Pensionit.

**Rreziku i kreditit** është rreziku i humbjes financiare për Fondin nëse një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Fondi merr në konsideratë këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku Individual i mospagimit dhe rreziku i sektorit).

Këshilli Administrativ i Fondit ia ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut kreditor drejtuesve të shoqërisë Administruese, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditit të Fondit. Investimet e Fondit janë në obligacione të Qeverisë së Shqipërisë, ndërsa paratë dhe ekuivalentët e saj janë pranë depozitarit.

**Rreziku i likuiditetit** është rreziku i krijimit të efekteve negative mbi aftësinë e shoqërisë administruese për të përmbushur detyrimet e saj. Shoqëria administruese kontrollon rrezikun e likuiditetit duke përcaktuar detyrimet dhe procedurat për të disponuar në mënyrë të përhershme sasinë e duhur të aktiveve likuide të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të saj.

**Rreziku operacional** i referohet humbjeve që mund të ndodhin si pasojë e gabimeve njerëzore në transaksionet e përditshme, sistemeve jo të përshtatshme të informacionit, dështimit të teknologjisë, ngjarjeve të paparashikuara apo procedurave të Shoqërisë Administruese. Në mënyrë që të minimizohet rreziku operacional, shoqëria administruese zhvillon sisteme të përshtatshme kontrolli të brendshëm dhe përcakton saktësisht procedurat dhe rregulloret për të gjithë punonjësit në të gjitha fushat e operacioneve, si dhe në rast eventesh të jashtme.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

**Rreziku i përputhshmërisë** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë administruese për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Shoqëria Administruese kryen rregullisht vlerësimin e aktiveve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit, përcakton procedurat e identifikimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe siguron që kapitali të jetë në nivelin minimal të kërkuar në përputhje me dispozitat ligjore. Në një nivel të jashtëm, kontrolli i përputhshmërisë me rregulloret kryhet nga depozitari.

**Rreziku ligjor** është rreziku i ndryshimeve të mundshme në legjislacionin shqiptar me impakt të drejtpërdrejtë mbi fondet e pensionit privat. I referohet rrezikut që rezulton nga ndryshimi i legjislacionit i cili rregullon veprimtarinë e Fondit dhe investimet në Fond. Këto ndryshime mund të reflektohen në mënyrën e trajtimit të skemës aktuale të pensioneve lidhur me trajtimin tatimor të përfitimeve, apo në moshën e përfitimit të pensionit. Interpretimet e ndryshme të ligjeve nga autoritetet tatimore dhe gjykatat nuk mund të përjashtohen.

**Rreziku ndryshimit të tatimit për pensionet privat** përfaqësohet nga ndryshimet e ardhshme në ligjet tatimore për pensionet private. Bazuar në dispozitat ligjore, anëtarët përfitojnë lehtësira tatimore që zbatohen në fazën e depozitimit të kontributeve dhe janë subjekt tatimi në fazën e përfitimit të pensionit, me normën e tatimit në fuqi në atë periudhë. Në këtë aspekt duhet mbajtur në konsideratë që norma e tatimit për pensionet mund të ndryshojë.

**Rreziku politik** lidhet me faktin që ndryshime apo ngjarje të rëndësishme politike kanë një ndikim material në mjedisin ekonomik të vendit. Ndryshime të tilla mund të çojnë në vështirësi paguese të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të cilat pasqyrohen në uljen e vlerës së obligacioneve dhe për pasojë në vlerën neto të aktiveve të Fondit.

Për administrimin e rreziqeve ligjore dhe politike, Shoqëria Administruese identifikon burimet e rrezikut, analizon dhe vlerëson në bazë të vazhdueshme impaktin e çdo ndryshimi në mjedisin ligjor dhe politik të vendit.

**Rreziku i agjencisë** është i lidhur me probabilitetin e ngjarjeve që përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve apo përdorimin e autoritetit të administratorit të Shoqërisë Administruese apo dhe menaxherëve të portofolit në përfitim individual kundrejt përfitimit të Fondit. Shoqëria Administruese ka implementuar mekanizma kontraktuale dhe të kontrollit për mirëfunksionimin e Shoqërisë Administruese dhe të Fondit, duke siguruar integritetin në të gjitha proceset në përputhje me ligjet, rregullat dhe mbrojtjen e aktiveve të Fondit. Një rol kryesor në proceset e kontrollit ka Banka Depozitare e cila kontrollon transaksionet e anëtarëve të Fondit dhe procesin e investimeve.

**Rreziku i Depozitarit** Funkzioni i depozitarit kryhet nga një subjekt i licencuar nga AMF siç shpjegohet në seksionin “DEPOZITARI”. Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore dhe në këtë rast disa aktivitete të fondit, si për shembull regjistrimi i aktiveve të Fondit apo përllogaritja e vlerës neto të aktiveve, mund të vonohen.

**Rreziku i reputacionit** përfaqëson potencialin për një dëmtim të imazhit si rrjedhojë e perceptimit negativ nga grupet e interesit/publiku për Fondin lidhur me veprime ose mosveprime të Shoqërisë Administruese dhe punonjësve të saj, ngjarje të cilat perceptohen si të papërshtatshme dhe jo-konsistente me vlerat e Fondit. Shoqëria Administruese ka ndërtuar modelin e biznesit të bazuar në besimin e publikut dhe ka krijuar standarde të qëndrueshme për identifikimin dhe vlerësimin e ngjarjeve që mund ta dëmtojnë atë, duke u kujdesur për zbatimin e rregullave dhe sigurimin e transparencës me anëtarët e Fondit.

**Rreziku nga delegimi i funksioneve** Shoqëria administruese harton dhe miraton politika për identifikimin e funksioneve që do të delegohen, duke vlerësuar ndikimin që do të ketë delegimi në veprimtarinë e shoqërisë. Personi i deleguar, të cilit do t'i delegohen funksionet e shoqërisë administruese, duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer këto funksione, njësoj sikur ato të kryeshin nga shoqëria. Funksionet e deleguara duhet të ushtrohen në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet aftësia, stabiliteti, vazhdimësia dhe cilësia e veprimtarisë së shoqërisë administruese. Delegimi i funksioneve, në asnjë rast, nuk shmang përgjegjësitë e organeve drejtuese të shoqërisë administruese.

### **Masat që do të merren për Administrimin e Rrezikut**

Për administrimin dhe mbajtjen nën kontroll të rrezikut, shoqëria administruese ka marrë masat e mëposhtme:

- Ngritjen e strukturave të menaxhimit të rrezikut dhe rregulloreve të funksionimit të menaxhimit të rrezikut në shoqërinë administruese;
- Identifikimin e shkeljeve të limiteve për tregtimin e instrumenteve financiare;
- Sigurimin e buxhetit të nevojshëm për burimet e administrimit të rreziqeve;

- Minimizimin e efekteve negative të tregtimit të parregullt të instrumenteve financiare;
- Promovimin e praktikave më të mira të administrimit të rrezikut;
- Rishikimin e vazhdueshëm të performancës me bazë rreziku dhe përditësimin e strategjive;
- Promovimin e një kulture të administrimit të rrezikut, ku kuptimi dhe administrimi i rrezikut është përgjegjësi e të gjithë punonjësve të shoqërisë administruese, të cilët duhet të veprojnë në përputhje me rregulloret;
- Sigurimin që të gjithë punonjësit të kuptojnë dhe të përvetësojnë njohuritë bazë të menaxhimit të rrezikut;
- Krijimin e besimit tek anëtarët e fondit në lidhje me administrimin sa më të mirë të fondit në përputhje me rregullat, ligjet dhe duke u bazuar në praktikat më të mira.

## VIII. PERFORMANCA E FONDIT DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Shoqëria Administruese përllëgarit çdo ditë Vlerën Neto të Aktiveve dhe çmimin e kuotës të cilat pasi kontrollohen dhe verifikohen nga depozitari, i cili është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes, publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese. Në rastet kur faqja zyrtare ka probleme të përkohshme teknike, anëtari mund të informohet me telefon apo pranë zyrës qendrore të Shoqërisë Administruese. Në faqen zyrtare janë të publikuara edhe raporte periodike mbi të ardhurat historike neto të fondit, të paraqitura me shifra dhe grafikisht, si dhe struktura aktuale e aktiveve të fondit me ndarjen në përqindje sipas tipeve të investimeve. Çdo Anëtar i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, pajiset me emër përdoruesi dhe fjalëkalim për të aksesuar online kudo dhe në çdo kohë llogarinë e tij në Fond.

### Metodologjia e vlerësimit të aktiveve

#### **Vlerësimi i portofolit të titujve të mbajtur deri në maturim (HTM)**

Titujt e klasifikuar nga shoqëria administruese si investime të mbajtura deri në maturim, do të vlerësohen me metodën e amortizimit linear të premium-it ose discount-it të titullit, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit të realizuar (yield) në momentin e çdo investimi fillestar. Norma efektive e interesit duhet të shprehet në katër shifra pas presjes dhjetore dhe shifra e fundit do të rrumbullakoset duke aplikuar metodën matematikore të rrumbullakosjes.

Në rastin e shitjes së një pjese të aktiveve të mbajtura për maturim, ose në rastin kur shoqëria e administrimit ndryshon synimin e saj (politikën e investimit) ose humbet aftësinë për të mbajtur aktivet deri në maturim, aktivet totale të mbajtura deri në maturim do të rivlerësohen përsëri me vlerën e drejtë. Nga dita kur ndodh shitja e pjesshme apo riklasifikimi, asnjë titull i mbetur nuk do të vlerësohet nga metoda e zbatuar për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim për dy vitet pasuese financiare. Përfundimisht do të bëjnë rastet e shitjes dhe riklasifikimit me karakteristikat e përshkruara nga SNK 39.9.

#### **Vlerësimi i portofolit të titujve për tregtim (AFS/HFT)**

Portofoli i titujve për AFS/tregtim do të rivlerësohet çdo ditë punë.

Të gjendur në situatën e një tregu jo-aktiv të obligacioneve, rivlerësimi me marrëveshje bëhet në bazë të përllëgaritjes me modelin e interpolimit linear të Yield-it deri në maturim duke u bazuar në Yield-et më të fundit të ankandeve të bonove të thesarit apo obligacioneve dhe ditëve të mbetura deri në maturim të obligacioneve për rivlerësim. Sa i përket ankandeve me rihapje, si datë emetimi do merret data e rihapjes. Për obligacionet maturiteti i mbetur do llogaritet duke përdorur 360 ditë në vitin kalendarik, ndërsa për bonot do përdoret konvencioni i 365 ditëve.

#### **Bonot e thesarit & Obligacionet**

Lidhur me Bono e thesarit dhe obligacionet si më poshtë përllëgaritja bazohet në Udhëzimin nr. 31 i datës 26.12.2013 për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi dhe Udhëzim nr.30 datës 26.12.2013 për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë së Bonove të Thesarit si formë regjistrimi.

### Bonot e thesarit

Çmimi për blerjen e Bonove të Thesarit llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i blerjes} = \frac{V_n}{1 + \frac{y}{d} * D}$$

$V_n$  - Vlera nominale

$y$  - yield (norma e interesit) shprehur në bazë vjetore

$d$  - ditë kalendarike

$D$  - ditët deri në maturim

### Obligacionet

Çmimi i obligacioneve të rihapura llogaritet si më poshtë:

Çmim (P) = Çmim i Pastër + Interesi akumuluar

Formula e aplikuar për gjetjen e çmimit të pastër është:

$$\text{Çmimi i pastër} = \frac{C_1 * d_1}{(1+Y_1*d_1)} + \frac{C_2 * d_2}{(1+Y_1*d_1) * (1+Y_2*d_2)} + \dots + \frac{C_n * d_n + M}{(1+Y_1*d_1)*(1+Y_2*d_2)*\dots*(1+Y_n*d_n)}$$

### Për obligacionin me interes të ndryshueshëm:

C- Kuponi.

Kuponat e ardhshëm, të panjohur në momentin e zhvillimit të ankandit janë të barabartë me shumën e Normës Spot 12 mujore me marzhin uniform të ankandit që rihapet.

d- raporti i ditëve të periudhës së pagesës së kuponit me 360 ditë (baza 30/360)

n- numri i pagesave të kuponit

$Y$  = Discount Margin + Normën Spot 12 mujore

Discount Margin- Kuotim individual i çdo agjenti në treg me të cilin është i gatshëm të tregtojë titullin (del nga rezultati i ankandit dhe aplikohet në mënyrë uniforme për të gjithë pjesëmarrësit).

Norma Spot 12 mujore- yieldi më i fundit i bonove të thesarit 12 mujore

M-vlera e maturimit të obligacionit (par value) që do të thotë se vlera e maturimit të obligacionit është e barabartë me 100% të vlerës nominale.

### Për obligacionin me interes fikse:

C- yield-i uniform i përcaktuar në momentin e emetimit në ankandin fillestar  $C_1=C_2=\dots=C_n$

d- raporti i ditëve të periudhës së pagesës së kuponit me 360 ditë (baza 30/360)

n- numri i pagesave të kuponit

$Y$ - yield-i individual i çdo agjenti në treg me të cilin është i gatshëm të tregtojë titullin (del nga rezultati i ankandit dhe aplikohet në mënyrë uniforme për të gjithë pjesëmarrësit)  $Y_1=Y_2=\dots=Y_n$

Për titujt referencë dhe instrumentet e tjerë që kanë maturim të mbetur afër instrumentit referencë si nyje maturiteti, vlerësimi ditor i tyre do kryhet duke marrë mesataren e thjeshtë të yield-eve të kuotuar nga Zhvilluesit e Tregut në ditën e caktuar.

Mesatarja e thjeshtë e yield të kuotuar në blerje (kuotimet bid) do të merret nga raportimi ditor i kuotimeve që kanë bankat zhvilluese të tregut për secilin titull, i cili është konsideruar si titull referencë.

Në këtë mënyrë, llogaritja e kuotimeve në blerje do të jetë mesatarja e thjeshtë e kuotimeve të të gjithë Zhvilluesve të Tregut.

Shembull:

Data	23/12/2021
ISIN	AL0045NF3Y24
FIKSI	2.54%

Zhvilluesit e tregut	BID	ASK	MESATARE
Banka 1	2.68%	2.38%	2.53%
Banka 2	2.70%	2.40%	2.55%
Banka 3	2.68%	2.38%	2.53%

Banka 4	2.68%	2.38%	2.53%
Banka 5	2.70%	2.40%	2.55%

Shënim: Fiksi llogaritet si mesatare e thjeshtë e mesatareve të kuotimeve individuale të Zhvilluesve të Tregut për atë titull.

Si datë emetimi do të konsiderohet data e vlerësimit. Mënyra e përdorur është në përputhje me kushtet e tregtimeve të shit-blerjeve në treg dhe metodologjive të përcaktimit të vlerës së tregut të titujve nga ana e bankave nëpërmjet të cilave ekzekutohen dhe tregtohen titujt.

Metoda e interpolimit mes dy nyjeve të kurbës së yield-eve, në rastet kur yield-i i tregut mungon për atë maturitet ose nuk janë zhvilluar ankande gjatë një periudhe:

Instrumenti	Ditë	Yield
3 mujor	D1	Y1
6 mujor	D2	$Y2 = (Y1 + ((Y3 - Y1) / (D3 - D1)) * (D2 - D1))$
12 mujor	D3	Y3

Për ankandet të cilat nuk kanë frekuenca zhvillimesh për 3 muaj, si interpolim për instrumentet me maturim të mbetur që bien afër këtyre nyjeve, do të përdoret nyja tjetër më e afërt.

Në rastet e blerjeve të titujve ekzistuese në portofolin e fondeve, në ditën e tregtimit (trade date), titujt do të regjistrohet me çmimin e blerjes dhe do të rivlerësohet me vlerën e tregut të po asaj dite.

Përlllogaritja e interesave fillon në ditën e settlement, last day accrual.

Në rastet kur titujt kanë më pak se shtatë ditë të mbetura deri në maturim, yield-i deri në maturim do të jetë norma bazë e interesit shtatë ditor (Repo).

Në fundjavë ose për çdo ditë pushimi zyrtar në Shqipëri, çmimet e instrumenteve do jenë të njëjtë me ato të ditës së fundit të punës.

Në rast se nuk ka publikime të yield-eve dhe çmimeve përkatëse për titujt për llogaritjen e çmimeve dhe vlerësimin ditor do të përdoren të dhënat e ditës së mëparshme.

Shoqëria do të marrë informacione për normat e tregut dhe të ankandeve të zhvilluara nga publikimet e paraqitura nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe nga raportimet e kuotimeve të bankave në platformën Reuters (sipas mundësisë).

### **Vlera neto e aktiveve dhe vlera e kuotave të fondit të pensionit**

Vlera neto të aktiveve të fondit do të llogaritet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ditë vlerësimi “t” është dita në të cilën bëhet përlllogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një ditë më parë “t-1”.

Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t), rezulton nga diferenca mes vlerës totale të aktiveve të fondit të pensionit, të një dite më parë (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit, llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit, të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për kontribuuesit gjatë ditës (t-1), të cilët kanë paguar kontributet në ditën (t-1), si dhe duke zbritur numrin e kuotave të tërhequra nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, apo të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).

*Detyrime të përlllogaritura* përfshijnë detyrimet në formën e pensionit të anëtarëve, detyrimet për tërheqjet e parakohshme, detyrimet për transferimin e aktiveve në një fond tjetër dhe tarifës që lidhet me transferimin dhe të tjera detyrime të përcaktuara nga ligji.



## Të drejtat që burojnë nga anëtarësia në fond

Anëtari i fondit të pensionit ka të drejtë:

- Të ketë pronësinë e aktiveve të investuara në Fond dhe kthimit nga investimi;
- Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
- Të drejtën për të kërkuar informacion mbi Fondin e Pensionit;
- Të informohet në periudha të rregullta kohore dhe sa herë të kërkohet nga anëtari, mbi vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij të pensionit;
- Të përcaktojë shumën e kontributeve që do të paguajë, të ndryshojë këtë shumë, si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
- Të mos penalizohet në rast se ndalon së paguari kontribute në fond;
- Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm;
- Të transferojë aktivet e veta, në çdo kohë dhe me kërkesën e tij në një fond pensioni tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese.

## IX. TATIMI

### Trajtimi fiskal i fondit

Fondi është një grup aktivesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat ose taksës mbi vlerën e shtuar (TVSH).

### Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtari

**Në zbatim të neneve 156, 157, 158 dhe 159 të ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Nenit 20 të Ligjit 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” dhe Nenit 20 të Udhëzimit Nr.26, datë 08/09/2023 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, anëtari i fondit ka këto lehtësira fiskale:**

1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi.
2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese.
3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribuues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit.
4. Kufiri maksimal mujor, për lehtësitë tatimore, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.
5. Blerja e kuotave të një fondi pensioni është shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja.
6. Shërbimet e ofruara nga depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe si rrjedhojë janë të përjashtuara nga TVSH-ja.
7. Tërheqja e parakohshme tatóhet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.
8. Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” nga një shoqëri sigurimi jete, që sjell një produkt me të ardhura të rregullta, periodike, do të trajtohet me të njëjtat lehtësi fiskale si pagesat periodike në formë pensioni të parashikuara në nenin 75 të ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

### Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një fond pensioni vlerësohen shpenzim operativ deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi, dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin.

### Trajtimi fiskal i pagesave të marra nga anëtari

1. Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë periodike mujore tatóhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.

2. Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar të parashikuara në nenin 75 të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat, taten në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.

### Trajtimi fiskal i përfitimeve të marra nga anëtari

Tërheqja e parakohshme taten me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.

## X. PAGESA E PËRFITIMEVE

Për të krijuar një ide se si kohëzgjatja e investimit në fond, madhësia e kontributeve që duhet të depozitohet anëtari në fond si dhe faktorë të tjerë ndikojnë për të përfituar një pension të përshtatshëm më poshtë jepen disa variante të pagesave të kontributeve dhe përfitimeve të përafërta të pensionit me qëllim që anëtari të kuptojë mënyrën e funksionimit të kësaj skeme pensioni.

### Shembulli 1

<b>Faza e investimit për pension</b>		<b>Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike</b>	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>10,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	6,963,629
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Shumë e menjëhershme		Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	3,600,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>42,198</b>
Kontributet + Interesat	6,963,629	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	3,163,944
Interesi i fituar gjatë investimit	3,363,629	Interesi i përfituar në total	6,527,573

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### Shembulli 2

<b>Faza e investimit për pension</b>		<b>Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike</b>	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>15,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	7,737,650
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	25	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Shumë e menjëhershme		Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	4,500,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>46,889</b>
Kontributet + Interesat	7,737,650	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	3,515,623
Interesi i fituar gjatë investimit	3,237,650	Interesi i përfituar në total	6,753,273

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### Shembulli 3

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>12,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	4,415,966
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme		Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	2,880,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>32,664</b>
Kontributet + Interesat	4,415,966	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	1,463,620
Interesi i fituar gjatë investimit	1,535,966	Interesi i përfituar në total	2,999,587

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### Shembulli 4

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>3,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	8,497,575
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	40	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	1,000,000	Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	2,440,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>62,586</b>
Kontributet + Interesat	8,497,575	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	2,816,421
Interesi i fituar gjatë investimit	6,057,575	Interesi i përfituar në total	8,873,996

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

*Shënim:*

*Përlllogaritjet e mësipërme janë ilustrative duke marrë për bazë vlera të përafërta investimi, por në çdo rast nuk përbëjnë garanci apo premtim për shumën apo normën e kthimit nga investimi.*

Norma e kthimit nga investimi i aktiveve të fondit të pensionit është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut. Përlllogaritjet e mësipërme janë të certifikuar nga Z. Arben ÇAVOLLI, aktuar i miratuar edhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, drejtor i departamentit të aktuaristikës të Shoqërisë së Sigurimit “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.

### Procedura e anëtarësimit në një Fond pensioni

**Prospekti.** Çdo këshilltar/punonjës i Shoqërisë Administruese, përpara se të fillojë prezantimin e fondit të pensionit dhe lidhjen e kontratës së fondit të pensionit me çdo anëtar i vendos këtij të fundit në dispozicion Prospektin e Fondit, i cili përmban informacion të vërtetë dhe korrekt për Fondin e Pensionit që administron, duke e konsideruar të këshillueshme njohjen me përmbajtjen e tij, përpara se të marrin vendim për tu anëtarësuar në Fond, në mënyrë që të krijojë një ide të qartë për funksionimin e Fondeve të Pensionit me Kontribute të Përcaktuara dhe mbajtjes së rrezikut të investimit. Prospekti përditësohet çdo vit dhe miratimi i tij ndodh vetëm për ndryshimet e rëndësishme.

**Formulari i aplikimit.** Personi i autorizuar nga Shoqëria Administruese (agjenti/punonjësi) DUHET ti vërë në dispozicion anëtarit Formularin e anëtarësimit, të cilin e plotëson me të dhënat personale të tij.

**Regjistri i fondit:** Pas plotësimit të formularit të anëtarësisë për anëtarët individ, apo Deklaratës së Pranimit për anëtarët punëmarrës të punëdhënësit i cili ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësit e tij dhe fotokopjimit të ID-së, punonjësi i Shoqërisë Administruese të Fondeve SIGAL, plotëson kontratën në sistem, duke shënuar të dhënat e anëtarit sipas formularit të plotësuar nga ana e tij/ Deklaratës së pranimit në rastin e punëmarrësve për të cilët punëdhënësit ka krijuar fond pensioni, shumën përkatëse që anëtari do të kalojë në llogarinë personale të pensionit. Në përfundim nga sistemi printohet kontrata në dy kopje. Anëtari pasi firmos kontratën pajiset me kartën personale të anëtarësisë. Kjo për t'i krijuar mundësinë që në çdo kohë të jenë të informuar për Aktivet dhe Kuotat në llogarinë e tij në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL.

Kuotat e fondit të pensionit janë të dematerializuara dhe mbahen në formë elektronike në regjistrin e pronësisë së fondit. Regjistri i pronësisë së fondit përbën dëshmi përfundimtare të të drejtave të anëtarëve mbi kuotat e regjistruara në të.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit të pensionit. Depozitari i fondit të pensionit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese në lidhje me këtë regjistrë është në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

### **Pagesa e Kontributeve**

Pas nënshkrimit të kontratës anëtari vendos se si do të bëjë derdhjen e kontributeve në llogari të Fondit të Pensionit, për llogari të vetë anëtarit. Pagesa e kontributeve bëhet pranë Bankës Depozitare, Banka Amerikane e Investimeve sh.a., në llogarinë me numër AL2821011012000000001745960, me kalim nga llogaria personale e anëtarit ose derdhje direkt në sportelet e bankës me përshkrim: emër, mbiemër, kodë përkatës i anëtarit si dhe periudha për të cilën po bëhet pagesa.

Kontributi për pension mund të paguhet në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Por gjithashtu mund të paguhet edhe si shumë e menjëhershme. Mënyra e pagesës së kontributit mund të bëhet cash, me transfertë bankare, direct debit dhe e-banking.

### **Përfundimi i anëtarësisë:**

Anëtarësia në fond përfundon:

- Kur të gjitha aktivet e anëtarit janë transferuar në një fond pensioni tjetër;
- Në rastin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha aktiveve;
- Në rastin e vdekjes së anëtarit.
- Brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit

Anëtari i fondit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit në fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike shoqërinë administruese.

Shoqëria administruese duhet t'i kthejë anëtarit vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, përjashtuar tarifën e administrimit për atë periudhë.

Shoqëria administruese duhet të bëjë pagesën në llogarinë bankare të anëtarit brenda 5 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim të anëtarit.

### **Llogaria personale e anëtarit në fondin e pensionit do të mbyllet:**

Nëse anëtari i fondit të pensionit ka zgjedhur të marrë pagesën e pensionit nëpërmjet një shoqërie të sigurimit të jetës, anëtarësia e tij në fond përfundon me kalimin e të gjitha aktiveve në llogarinë e anëtarit në shoqërinë e sigurimit të jetës.

Nëse anëtari i fondit plotëson kushtet për marrjen e pagesës së pensionit dhe ka zgjedhur marrjen e pagesës nëpërmjet shoqërisë administruese, anëtarësia e tij në fond nuk do të përfundojë vetëm kur të jenë shlyer dhe kuotat e fundit në llogarinë e anëtarit në fondin e pensionit.

Anëtari në një fond pensioni privat me pjesëmarrje të hapur mund të tërhiqet nga anëtarësia në fond nën kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratën e anëtarësimit.

## Disa opsione për të investuar në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL

### 1. Paga mujore kontributesh dhe përfitim i menjëhershëm

Ky opsion ofron pagesa të përmuajshme të kontributeve dhe përfitime të menjëhershme të aktiveve. Anëtarit i lind e drejta të përfitojë pension në varësi të zgjedhjes së tij: në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe.

Kontributi mujor	Pas 15 vitesh		Pas 20 vitesh		Pas 25 vitesh		Pas 30 vitesh	
	Përfitim i Menjëhershëm	Fitimi	Përfitim i Menjëhershëm	Fitimi	Përfitim i Menjëhershëm	Fitimi	Përfitim i Menjëhershëm	Fitimi
10,000	2,684,000	884,000	4,127,000	1,727,000	5,979,000	2,979,000	8,357,000	5,357,000
15,000	4,026,000	1,326,000	6,191,000	2,591,000	8,969,000	4,469,000	12,535,000	8,035,000
20,000	5,368,000	1,768,000	8,254,000	3,454,000	11,959,000	5,959,000	16,714,000	10,714,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### 2. Paga të menjëhershme dhe pension mujor sipas viteve

Ky opsion ofron pagesë të menjëhershme të kontributeve të cilat investohen për një periudhë të caktuar dhe anëtari në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe, përfiton pension mujor. Periudha në të cilën investohen aktivet është e barabartë me periudhën e përfitimit të pensionit mujor.

Kontribut i menjëhershëm (Lekë)	Pension mujor për 10 vite	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 15 vite	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 20 vite	Fitimi (Lekë)
500,000	8,700	544,000	8,400	1,012,000	8,900	1,636,000
1,000,000	17,500	1,100,000	16,500	1,970,000	18,000	3,320,000
2,000,000	35,000	2,200,000	33,000	3,940,000	36,000	6,640,000
5,000,000	87,000	5,440,000	83,000	9,940,000	89,000	16,360,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### 3. Pagesë të menjëhershme dhe përfitim i menjëhershëm

Në këtë opsion anëtari depoziton një shumë të caktuar dhe zgjedh ta tërheqë menjëherë në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe.

Kontribute të menjëhershme	Përfitime të menjëhershme pas 10 vitesh investimi	Fitimi	Përfitime të menjëhershme pas 15 vitesh investimi	Fitimi
500,000	823,000	323,000	1,100,000	600,000
1,000,000	1,640,000	640,000	2,100,000	1,100,000
2,000,000	3,300,000	1,300,000	4,200,000	2,200,000
5,000,000	82,000,000	77,000,000	10,560,000	5,560,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

#### 4. Pagesa të menjëhershme dhe përfitim mujor sipas viteve

Në këtë option anëtari i cili është në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe, depoziton një shumë të menjëhershme dhe zgjedh të përfitojë një pension mujor, ndërkohë që aktivet e mbetura në llogari vazhdojnë të investohen.

Kontribute të menjëhershme	Pension mujor për 10 vite	Fitimi	Pension mujor për 15 vite	Fitimi	Pension mujor për 20 vite	Fitimi
500,000	5,300	136,000	3,970	214,600	3,300	292,000
1,000,000	10,600	272,000	8,000	440,000	6,600	584,000
3,000,000	31,900	828,000	23,800	1,284,000	19,800	1,752,000
4,000,000	42,000	1,040,000	31,000	1,580,000	26,500	2,360,000
5,000,000	53,000	1,360,000	39,000	2,020,000	33,000	2,920,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

*Shënim:*

*Përlllogaritjet e mësipërme janë ilustrative duke marrë për bazë vlera të përafërta investimi, por në çdo rast nuk përbëjnë garanci apo premtim për shumën apo normën e kthimit nga investimi.*

## XI. PAGESA E PENSIONIT

Anëtari i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet ose pagesat periodike në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere kur:

- mbush moshën e pensionit, të parashikuar me ligj, për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar;
- 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;
- bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ai duhet të paraqitet pranë zyrave të Shoqërisë Administruese, të bëjë kërkesë për të tërhequr fondet e tij duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë dhe dokumentacionin përkatës sipas rastit. Anëtari duhet të lërë një numër llogarie të saktë për kalimin e Fondeve si dhe një numër kontakti me qëllim që të informohet për këtë kalim.

Anëtari i fondit të pensionit ka të drejtë të ndërpresë anëtarësinë e tij në fond, pra të mos kryejë më pagesa për llogari të tij, për arsye të ndryshme. Ky veprim nuk ka asnjë pasojë negative pasi fondet janë të anëtarit në çdo kohë. Ato vazhdojnë të investohen dhe të fitojnë interes edhe pse derdhjet e kontributit kanë ndaluar.

Anëtari i fondit të pensionit gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti”, të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga Autoriteti.

E drejta e pakushtëzuar e anëtarit të fondit për marrjen e pagesës së menjëhershme të të gjitha aktiveve neto në llogarinë e tij në fondin e pensionit apo e pagesave periodike në formë pensioni, pas plotësimit të kushteve, sipas legjislacionit në fuqi, shkruhet qartë në kontratë dhe prospektin e fondit të pensionit privat.

## **XII. MËNYRA E PAGESËS SË PENSIONIT**

Anëtari i fondit të pensionit gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për:

### **Pagesa e pensionit përmes shoqërisë së sigurimit të jetës**

Nëse anëtari i fondit të pensionit, me plotësimin e kushteve për të përfituar pension, vendos të blejë një kontratë të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” nga një shoqëri sigurimi jete, vlera neto e aktiveve në llogarinë e anëtarit të fondit do të transferohet te shoqëria e sigurimit të jetës sipas opsionit të zgjedhur nga anëtari i fondit.

Shoqëria administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e anëtarit të fondit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë “anuiteti”. Shoqëria e sigurimit të jetës që ofron shërbimin e pagesës së pensionit, përveç dispozitave të këtij ligji, duhet të zbatojë gjithashtu dispozitat e ligjit që rregullojnë krijimin dhe veprimtarinë e shoqërive të sigurimit.

Vlera neto në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, e transferuar te shoqëria e sigurimit të jetës, duhet të përdoret vetëm për qëllim të blerjes së një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës.

### **Pagesa e pensionit në mënyrë periodike**

Pavarësisht vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij, me plotësimin e kushteve për të përfituar pension, anëtari i fondit mund të vendosë të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjatura në kohë, jo më pak se 2 vjet.

Në rastin e pagesës së pensionit periodik midis Anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese, do të nënshkruhet një kontratë mbi pagesat periodike.

Anëtari i Fondit në mënyrë të pavarur përcakton shumën dhe datën e pagesave periodike të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij.

Sipas preferencës së Anëtarit shumën e pagesës periodike përcaktohet si numër kuotash ose si vlerë në monedhën Lek.

Shoqëria i dërgon depozitarit përllogaritjet për kalimin e pensioneve periodike. Pas konfirmimit nga depozitari të këtyre përllogaritjeve plotësohet urdhri për kalimin e tyre në llogaritë e anëtarëve.

Pensioni paguhet në lekë në llogarinë bankare të anëtarit, sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim nga shoqëria administruese me anëtarin.

### **Pagesa e pensionit në mënyrë të menjëhershme**

Me përmbushjen e kushteve për të përfituar pension, anëtari i fondit ka të drejtë të marrë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e tij në formën e një pagese të menjëhershme. Tërheqjet e menjëhershme taten në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra përfshirë edhe kontributet.

Pas marrjes së njoftimit nga shoqëria administruese, anëtari i fondit i bën një kërkesë shoqërisë për marrjen e pagesës së plotë të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij.

Shoqëria Administruese i paraqet urdhrin Depozitarit, në mënyrë që ai të kryejë pagesën e totalit të aktiveve të akumuluar në llogarinë individuale të Anëtarit brenda 15 ditë pune nga depozitimi i dokumentacionit të plotë dhe plotësimi i kërkesës.

Pensioni paguhet në lekë në llogarinë bankare të anëtarit, sipas kërkesës së lidhur për këtë qëllim nga shoqëria administruese me anëtarin.

Shoqëria Administruese për çdo rast të vonuar në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike, detyrohet t'i paguajë anëtarit të fondit të pensionit shumën shtesë, në formë interesi.

Shuma e interesit të pagueshëm tek anëtari i fondit për çdo pagesë të vonuar llogaritet proporcionalisht:

- (a) Për çdo ditë vonesë, duke filluar që nga dita e parë kur lind detyrimi për kryerjen e pagesës, deri në ditën kur kryhet pagesa.
- (b) Mbi shumën e pagesës së vonuar.

Në llogaritjen e interesit do të përdoret norma e interesit TRIBID, 12 mujore, e kërkuar për pranimin e depozitave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 5%.

Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, taten me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.

## Humbja e jetës së anëtarit

Nëse anëtari humb jetën përpara se të marrë pagesën e të gjitha aktiveve të veta, aktivet e mbetura në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve sipas aktit të trashëgimisë dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi trashëgiminë.

## XIII. TËRHEQJA E PARAKOHSHME

Nëse anëtari i Fondit kërkon të tërheqë aktivet e akumuluar në llogarinë e tij individuale, përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj, do të konsiderohet tërheqje e parakohshme.

Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitete, që llogariten në raport me kohën e përmbushur nga anëtari nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme.

Penaliteti i tërheqjes së parakohshme administrohet nga Shoqëria Administruese, përpara kryerjes së veprimit të tërheqjes së parakohshme nga ana e anëtarit të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL.

Shoqëria Administruese brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit, urdhëron Depozitarin, i cili përpara se të kryejë pagesën e aktiveve që do të tërhiqen nga Anëtari, mban penalitetin e tërheqjes së parakohshme dhe e kalon për llogari të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL.

**Penalitetet e Tërheqjes së Parakohshme** – Tërheqja e parakohshme, krahas pagesës së tatimit e cila është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes, shoqërohet dhe me penalitete.

Për tërheqjet e parakohshme të pensionit, anëtarët e fondit të pensioneve do të paguajnë penalitete si më poshtë:

- 2 % të të gjitha aktiveve të tërhequra pas 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë.
- 5 % të të gjitha aktiveve të tërhequra pas 10 deri 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë.
- 10 % të të gjitha aktiveve të tërhequra pas 5 deri 10 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë.
- 15 % të të gjitha aktiveve të tërhequra deri 5 vjet nga dita e pagesës së parë të kontributeve

Në rastin kur Anëtari transferon aktivet në një fond tjetër të pensioni, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rastin e tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga Fondi i ri, në kohëzgjatjen e anëtarësimit do të përfshihet edhe periudha e anëtarësimit në fondin e mëparshëm.



## XIV. TRANSFERIMI I AKTIVEVE

Anëtari i fondit të pensionit ka të drejtë të transferojë aktivet në llogarinë e tij në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një shoqëri administruese tjetër.

Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese nuk shoqërohet me komision transferimi.

Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një shoqëri tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për të transferuar aktivet njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.

Shoqëria administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë administruese tjetër.

Në rastin e transferimit brenda të njëjtës shoqëri administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga anëtari.

Brenda 5 ditëve pune nga dita e transferimit të llogarisë, shoqëria informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

Transferimi i aktiveve në llogarinë e anëtarit në një fond pensioni të administruar nga një shoqëri tjetër administruese shoqërohet me një komision transferimi nga fondi deri në masën 0.5 % të shumës së transferuar.

## XV. TARIFAT DHE KOMISIONET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Për administrimin e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, Shoqëria Administruese, nga aktivet e fondit të pensionit dhe nga aktivet e anëtarëve, do të mbajë tarifaf dhe komisionet e mëposhtme:

**1.Për Koston e Administrimit** – Komisioni vjetor i administrimit të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL do të jetë në nivelin deri 1.5% në vit të vlerës neto të aktiveve të fondit.

Ky është komisioni i vetëm që mbahet nga totali i aktiveve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, bazuar në Nenin 155 pika 3 e Ligjit “Për Fondet e pensionit Privat”.

Kostoja totale vjetore që do të zbritet nga totali i aktiveve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, nuk mund të kalojë në asnjë rast 2.5 % të vlerës neto të aktiveve të fondit. Kjo kosto llogaritet në bazë ditore mbi aktivet totale të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL dhe kalon në llogari të Shoqërisë që administron këtë fond brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Komisioni vjetor i administrimit do të llogaritet në fund të çdo dite dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës ose në ditën e parë të muajit pasardhës. Komisioni vjetor i administrimit do të llogaritet si përqindje e raportit të vlerës së aktiveve neto të Fondit me totalin e ditëve.

### Shembull

Llogaritja e komisionit të koston së administrimit do jetë mbi bazën e vlerës neto të aktiveve të fondeve nën administrim për muajin përkatës.

- Komisioni vjetor për shoqërinë administruese është 1.5%
- Kontributi mujor 5,000.00 lekë
- Fitimi mujor nga investimi është:  $7\% \text{ (bruto)} / 12 \times 5,000.00 = 29.17$  lekë
- Aktivet e anëtarit (kontributi + fitimin) në fund të muajit do të jenë 5,029.17 lekë

- Komisioni i administrimit të muajit do të jetë:  $1.5\% / 12 \times 5,029.17 = 6.29$  lekë.
- Vlera neto e aktiveve të anëtarit në fund të muajit do të jetë  $5,029.17 - 6.29 = 5,022.88$  lekë
- Komisioni mujore për koston e administrimit do të jetë 6.29 lekë

**2. Transferimi i aktiveve** në llogarinë e anëtarit në një fond pensioni të administruar nga një shoqëri tjetër administruese shoqërohet me një komision transferimi në masën 0.5 % të shumës së transferuar. Kjo tarifë paguhet e gjitha nga llogaria e anëtarit në momentin e transferimit të aktiveve të tij në një Fond tjetër pensioni privat.

**3. Tarifa të tjera** – Anëtari i Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, sipas kërkesës së vetë anëtarit, është i detyruar që të paguajë nga llogaria e tij të gjitha shërbimet shtesë të cilat kanë kosto për shoqërinë administruese. Këto kosto mund të lidhen me shërbime të ndryshme bankare, shërbime postare, etj.

Çdo rritje e komisioneve dhe tarifave të zbatuara nga Shoqëria Administruese, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, u njoftohet anëtarëve, të paktën, 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

## XVI. DEPOZITARI

Në zbatim të ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, aktivet e fondit të pensioneve, përfshirë mjetet monetare mbahen tek një depozitar i vetëm, i cili duhet të jetë një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtarinë e Depozitarit.

Shoqëria Administruese, ka lidhur marrëveshje kujdestarie me bankën “Abi Bank sh.a.” me seli në adresën: Rruga e Kavajës Nd. 27, H.1, NB10 Tiranë. Kjo bankë, në përputhje me ligjin nr.76/2023 ” Për Fondet e Pensionit Privat” për ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë, të depozitimit dhe të besimit për aktivet e fondit.

Depozitari Abi Bank sh.a. është një entitet ligjor i rregulluar , licencuar dhe mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me nr.14 datë 28.10.1999.

Mban dhe licencën si Depozitar i Fondit të Pensioneve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendimin nr.92, datë 03.07.2017.

Llogaria e derdhjeve të kontributeve të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL, pranë ABI BANK sh.a. është: **IBAN : AL28 2101 1012 0000 0000 0174 5960**

### Roli dhe funksionet e Depozitarit

Depozitari është përgjegjës për ruajtjen e aktiveve të fondit të pensionit.

Depozitari i mban aktivet, veprimet dhe dokumentet e fondit, të ndara nga njëra-tjetra dhe nga mjetet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.

Depozitari i fondit kontrollon dhe verifikon llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimin e kuotës në përputhje me politikat e kontabilitetit dhe metodologjinë e vlerësimit.

Depozitari është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes dhe nënshkruan dokumentin që përmban përcaktimin e vlerës së aktiveve dhe mban një kopje në dosjen e vet, e cila i vihet në dispozicion Autoritetit në inspektim, sipas kërkesës. Nëse depozitari gjatë kontrollit të llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit identifikon pasaktësi dhe/ose parregullsi, njofton menjëherë me shkrim ose në mënyrë elektronike shoqërinë administruese.

Në rast se llogaritja dhe kontrolli i vlerës neto të aktiveve të fondit nuk kryhen brenda afatit të parashikuar, shoqëria administruese dhe depozitari duhet të njoftojnë Autoritetin duke specifikuar arsyet për të cilat është e pamundur të përcaktohet vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit.

Depozitari i fondit të pensionit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese në lidhje me këtë regjistër është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Depozitari është dhe do të vijojë të mbetet tërësisht i pavarur nga shoqëria administruese dhe nga çdo palë tjetër, që ka lidhje me shoqërinë administruese.

Depozitari është i detyruar të ruajë konfidencialitetin për çdo informacion të marrë.

## Detyrat e Depozitarit

Depozitari i fondit të pensionit privat kryen këto detyra:

- a) mban dhe regjistron pasuritë/aktivet e fondit;
- b) monitoron vazhdimisht flukset e mjeteve monetare të fondit dhe në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga anëtari ose në emër të anëtarit dhe se të gjitha mjetet monetare të fondit të pensionit janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të fondit, shoqërisë administruese për llogari të fondit ose të depozitarit për llogari të fondit;
- c) mban regjistrin e anëtarëve të fondit dhe të dhënat për çdo transferim për fondet e pensionit;
- ç) mban llogari për aktivet e fondit të pensionit dhe siguron ndarjen e aktiveve për secilin fond për të cilin ofron shërbimet e depozitarit nga aktivet e depozitarit dhe klientëve të tjerë të depozitarit dhe shoqërisë administruese;
- d) kontrollon që aktivet e fondit të pensionit investohen në përputhje me objektivat dhe strategjinë e investimit të miratuar, dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji;
- dh) informon Autoritetin dhe shoqërinë administruese për procedurën e llogaritjes së vlerës së aktiveve dhe çmimit të kuotës së fondit të pensionit, konfirmon llogaritjen dhe siguron që llogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimi i kuotës së fondit të pensionit janë kryer në përputhje me politikat e miratuara të kontabilitetit, metodologjitë e vlerësimit, si dhe në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- e) ekzekuton urdhrat e shoqërisë administruese në lidhje me transaksionet e aktiveve të fondit, nëse nuk bien ndesh me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- ë) raporton te shoqëria administruese për veprimet tregtare në lidhje me aktivet e fondit të besuara në kujdestari dhe ekzekuton urdhrat e shoqërisë administruese;
- f) garanton kthimin e çdo shume përkatëse fondit të pensionit brenda afateve kohore të përcaktuara;
- g) siguron që të gjitha të ardhurat, që rrjedhin nga transaksionet me aktivet e fondit, të dërgohen në llogarinë e fondit brenda afateve të përcaktuara;
- gj) garanton se të ardhurat e fondit të pensionit përdoren në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji;
- h) sigurohet që kostot ose tarifat e paguara nga fondi i pensionit janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tij;
- i) kryen të gjitha detyrat e tjera të parashikuara në kontratën për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit të fondit të pensionit.

Depozitari raporton menjëherë me shkrim në Autoritet çdo shkelje ose çdo dyshim të arsyeshëm për shkelje të këtij ligji dhe kontratës për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit të fondit të lidhur me shoqërinë administruese. Në këtë rast depozitari informon Autoritetin edhe për hapat e ndërmarrë nga depozitari për të ndrequr shkeljen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe informon në lidhje me afatin për ndreqjen e shkeljes në fjalë. Depozitari informon më tej Autoritetin nëse ndreqja është përmbushur brenda këtij afati.

Depozitari mban evidencat e nevojshme që i japin mundësi të jetë në përputhshmëri me kërkesat e këtij ligji dhe i mban këto evidenca për një periudhë kohore sipas parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.

## Konflikti i interesit të Depozitarit

Depozitari gjatë kryerjes së detyrave të tij, të parashikuara nga ligji 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe kontrata për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit, duhet të veprojë me kujdesin e një eksperti të mirë, me

ndërgjegje dhe ndershmëri, i pavarur nga shoqëria administruese, aksionarët e saj ose anëtarët e fondit për të cilin kryen veprimtari depozitari.

Depozitari nëpërmjet strukturës së tij organizative dhe akteve të brendshme gjatë kryerjes së veprimtarisë dhe detyrave të parashikuara nga ligji 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe kontrata për kryerjen e veprimtarisë së depozitarit duhet të shmangë konfliktin e interesit midis vetë depozitarit, aksionarëve dhe/ose mbajtësit të pjesëmarrjes influencuese dhe shoqërisë administruese.

Konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interes të anëtarëve të fondit.

Shoqëria e licencuar si depozitar nuk zotëron licencë si shoqëri administruese, por mund të zotërojë pjesërisht ose plotësisht një shoqëri, e cila ka licencë si shoqëri administruese e fondeve.

Në këtë rast shoqëria administruese dhe banka depozitare si aksionar i kësaj shoqërie nuk mund të kryejnë funksionet e tyre për të njëjtin fond pensioni.

Personat kyç, personeli kyç dhe punonjës të tjerë të depozitarit nuk mund të jenë persona kyç, personel kyç dhe punonjës të shoqërisë administruese dhe anasjelltas.

## **XVII. AUDITI I JASHTËM**

Shoqëria Administruese llogaritë e veta dhe të Fondit që administron, krahas strukturave të kontrollit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut, i auditon çdo vit dhe në afate të ndërmjetme edhe nga Auditues të Jashtëm.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a., ka auditues të jashtëm kompaninë audituese Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. e cila është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. ka zyrën qendrore në adresën Rr.Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9/1, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar me nr. fiskal L92014010J, me nr. Regjistri 701 në regjistrin e audituesve ligjorë.

Tel: 04 229 0700

E-mail: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: <https://www.pwc.com/al>

Personat përgjegjës: Laureta Këlliçi (Administratore)

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

## **XVIII. BASHKIMI, NDARJA DHE SHNDËRRIMI I FONDIT TË PENSIONIT**

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL mund të ndahet në disa fonde të tjera ose të bashkohet me fonde të tjera, gjithmonë me miratimin e Autoritetit.

Ndryshimi i formës së fondit, qoftë përmes bashkimit, ndarjes apo shndërrimit, nuk lejohet nëse kjo dobëson pozicionin ekonomik të anëtarëve ose dëmton interesat e tyre. Në rast falimenti, likuidimi të sponsorit të fondit, ose mbyllje të aktivitetit tregtar të sponsorit, është e detyrueshme ndryshimi i formës së fondit me pjesëmarrje të mbyllur, gjithmonë me miratimin e Autoritetit.

**Bashkimi i fondeve** të pensionit realizohet duke transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një ose më shumë fondeve të pensionit (fond transferues) tek një fond ekzistues (fond marrës) ose duke krijuar një fond të ri. Në të dyja rastet, anëtarët marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen.

Pas bashkimit, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit transferues, dhe vlera totale e kuotave që zotëronte anëtari në fondin marrës duhet të jetë e barasvlershme me atë që kishte në fondin transferues. Shoqëria administruese e fondit marrës vazhdon të gjitha marrëdhëniet juridike të fondit transferues.

## Ndarja e një fondi

Ndarja e fondit të pensionit kryhet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi pensioni transferohen në dy ose më shumë fonde marrëse dhe fondi transferues prishet.

Ndarja e fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde ekzistuese, është ndarje me marrje në dorëzim. Ndarja e fondit, duke transferuar të drejtat dhe detyrimet në dy ose më shumë fonde, të krijuar për qëllim të ndarjes, është ndarje me themelim.

Fondi mund të ndahet në vetëm dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur.

Pas realizimit të ndarjes, vlera neto e aktiveve të fondit marrës duhet të jetë e barasvlershme me vlerën neto të aktiveve të fondit që ndahet.

Vlera totale e të gjitha kuotave, që zotëron anëtarin në fondin marrës, pas ndryshimit të statusit të fondit si rezultat i ndarjes, duhet të jetë e barasvlershme

## XIX. LIKUIDIMI VULLNETAR DHE I DETYRUAR I SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Likuidimi i shoqërisë administruese, kryhet vetëm pas miratimit të Autoritetit.

### Likuidimi vullnetar i shoqërisë administruese të fondeve të pensionit

Hapja e procedurës së likuidimit vullnetar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Vendimi duhet të merret nga jo më pak se 75% e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.

Kërkesa për likuidim vullnetar i paraqitet për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Si likuidator emërohen të paktën 2 persona fizikë, me miratim të Autoritetit, të cilët kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara, si dhe janë të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave.

Autoriteti merr vendim lidhur me kërkesën, brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës nga Shoqëria Administruese, së bashku me dokumentacionin e plotë. Autoriteti miraton likuidimin

vullnetar vetëm nëse gjykon se mund të paguhet të gjitha detyrimet kundrejt pronarëve dhe kreditorëve të shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe, personat kyç të shoqërisë kryejnë detyrat e zakonshme, por nuk angazhohen në detyrime të reja kundrejt të tretëve.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme nuk sjell pasoja juridike nëse Autoriteti refuzon të japë miratimin për hapjen e procedurës së likuidimit vullnetar.

Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit vendimin e miratimit për hapjen e likuidimit vullnetar.

Në rastet kur Autoriteti miraton procedurën e likuidimit vullnetar, ai mund të vendosë:

a) të kufizojë licencën për të ushtruar veprimtarinë e shoqërisë dhe të lejojë kryerjen e veprimtarive të përcaktuara ose ato veprimtari që janë të nevojshme për likuidimin vullnetar;

b) të përcaktojë se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të rrezikut në shoqërinë në likuidim vullnetar;

c) pavarësisht nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, Autoriteti mund t’i kërkojë shoqërisë të ndërmarrë masa të posaçme lidhur me mbrojtjen e anëtarëve të fondit.

Shoqëria në procedurë likuidimi vullnetar vijon të ekzistojë në mënyrë që të shlyejë shpenzimet dhe detyrimet kundrejt të tretëve, të shpërndajë aktivet dhe të kryejë veprimet e nevojshme për përfundimin e likuidimit vullnetar.

Likuiduesit mund të shkarkohen dhe të zëvendësohen sipas të njëjtave kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Veprimtaria e likuiduesit merr të drejtat dhe detyrimet e administratorëve, që nga dita e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, likuiduesit i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet në mënyrë solidare në përputhje me këtë ligj, me përjashtim të rastit kur akti i emërimit parashikon që likuiduesit të veprojnë të ndarë nga njëri-tjetri. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë operacione të një kategorie të veçantë. Likuiduesi është objekt i mbikëqyrjes nga Asambleja e Përgjithshme.

Detyra e likuiduesve është të përmbyllin të gjitha operacionet e shoqërisë, të shesin aktivet e shoqërisë dhe të paguajnë kreditorët duke respektuar rendin e përmbushjes së pretendimeve sipas këtij ligji.

Nëse në bazë të të drejtave të kërkueshme të kreditorëve, likuiduesit arrijnë në përfundimin që pasuria dhe aktivet e shoqërisë janë të pamjaftueshme për shlyerjen e këtyre të drejtave, likuiduesit pezullojnë procedurën e likuidimit dhe i kërkojnë gjykatës përkatëse hapjen e procedurës së falimentit.

Likuiduesi harton një pasqyrë bilanci të situatës së shoqërisë pas emërimit të tij. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 vit, likuiduesi harton edhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pasqyra e bilanci miratohet me vendim të 1/2 së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.

Likuiduesi i fton kreditorët e shoqërisë, duke përjashtuar aksionarët, të parashtrajnë pretendimet e tyre në likuidimin vullnetar. Shoqëria e publikon 2 herë këtë njoftim, me një interval kohe prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Likuiduesi nuk i shpërndan aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit 3-mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve për ngritjen e pretendimeve të tyre.

Nëse një detyrim nuk shlyhet dot menjëherë ose është objekt i pretendimeve të kërkueshme, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë një garanci e përshtatshme.

Pas shlyerjes së detyrimeve kundrejt kreditorëve dhe anëtarëve, likuiduesi ua shpërndan aktivet e mbetura në mënyrë përpjesëtimore aksionarëve.

Pas pagimit të detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve dhe aksionarëve, likuiduesi i dorëzon Autoritetit brenda 12 muajve një raport për procedurën e likuidimit dhe një propozim për shpërblimin e punës së tij.

Nëse Autoriteti nuk e miraton raportin, likuiduesi ndjek rekomandimin e bërë nga Autoriteti.

Pas miratimit të raportit nga likuiduesi, Autoriteti ia heq licencën e dhënë shoqërisë.

Pas heqjes të licencës nga Autoriteti, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Asnjë ankesë ose kundërshtim nuk mund të bëhet kundër veprimtarisë së likuiduesit pas përfundimit të çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Aktivitetet e fondit të pensionit, që ka nën administrim një shoqëri administruese, nuk mund të jenë objekt ekzekutimi si pasojë e procedurave të likuidimit ose të falimentimit të shoqërisë administruese, sipas legjislacionit shqiptar, as të shlyerjes apo të ekzekutimit të pretendimeve kundrejt shoqërisë administruese.

## Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm

Autoriteti merr vendim për vendosjen në likuidim të detyrueshëm të shoqërisë administruese kur konstaton se ekzistojnë një ose më shumë prej rrethanave të mëposhtme:

- a) shoqëria nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e veta brenda afatit;
- b) shoqëria kryen ose ka kryer veprimtari në shkelje të këtij ligji;
- c) autoriteti gjykon se është vendimi i duhur dhe i drejtë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë e saj;
- ç) kjo procedurë rekomandohet në kuadër të procesit të përfunduar të rimëkëmbjes dhe rehabilitimit.

Autoriteti për të garantuar mbrojtjen e anëtarëve të fondit të pensionit, mund të kërkojë që fondi/et t'i kalohet/n një personi juridik tjetër të licencuar si shoqëri administruese për administrimin e fondeve të pensionit privat. Autoriteti vlerëson situatën dhe vendos lidhur me fillimin e procedurave të likuidimit të detyrueshëm.

Autoriteti vendos shoqërinë administruese në likuidim të detyrueshëm menjëherë pasi arrin në një përfundim lidhur me rrethanat përkatëse.

Autoriteti publikon vendimin e vendosjes së shoqërisë në likuidim të detyrueshëm në faqen e tij të internetit.

## XX. INFORMIMI I ANËTARËVE MBI VLERËN E AKTIVEVE DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

Shoqëria Administruese siguron një transparencë të vazhdueshme për anëtarët e fondit duke i informuar për situatën e aktiveve të tyre nëpërmjet:

a) sistemit duke mundësuar kontroll 24 orë në llogaritë individuale të anëtarëve në faqen e internetit [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al)

b) Shoqëria administruese harton një dokumentin “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit.” për gjendjen e llogarisë së pensionit për çdo anëtar të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL. Vërtetimi i vihet në dispozicion çdo anëtarit, pa pagesë, në formë elektronike, të paktën 1 (një) herë në vit. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

c) Shoqëria administruese përpara daljes në pension të anëtarit, përveç vërtetimit për gjendjen e llogarisë së pensionit, 3 muaj përpara se anëtarit të arrijë moshën për pension, informon anëtarin për vlerësimin aktual të llogarisë individuale, si dhe ta pajisë me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe i jep udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aktiveve neto për çdo anëtar të Fondit.

Shoqëria administruese publikon vlerën neto të aktiveve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese.

### Ndryshimet e rëndësishme të prospektit

Nëse pas publikimit të prospektit të fondit dhe gjatë ofrimit të fondit të pensionit ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm, që ndikon në informacionet që përmban prospekti ose në rast të një informacioni të ri të rëndësishëm, në prospekt bëhen shtesat dhe ndryshimet përkatëse.

Ndryshime të rëndësishme të prospektit të fondit të pensionit janë ndryshimet që ndryshojnë qëllimin ose natyrën e fondit, që mund të kenë pasoja të rëndësishme, të padëshirueshme për anëtarin e fondit, që ndryshojnë profilin e rrezikut të fondit ose mënyrën e pagesës. Në këto ndryshime përfshihen:

a) rritja e tarifave të administrimit, komisionit të transferimit, si dhe përfshirja e një komisioni të ri të padeklaruar më parë në prospekt, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj;

b) ndryshimi i objektivave të investimit të fondit dhe rreziqeve të lidhura me investimet e parashikuara të fondit;

c) ndryshimi i profilit të rrezikut të fondit të pensionit ose aftësisë mbajtëse të rrezikut.

Ndryshimet si më sipër janë objekt i miratimit nga Autoriteti.

### Detyrimi për të publikuar prospektin

Shoqëria administruese brenda pesë ditëve pas marrjes së njoftimit me shkrim për miratimin e prospektit nga Autoriteti, publikon prospektin në faqen e internetit.

Çdo ndryshim i rëndësishëm i prospektit, pas miratimit nga Autoriteti, si dhe çdo ndryshim tjetër njoftohet nëpërmjet faqes së internetit të shoqërisë administruese [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al), si dhe i vihet në dispozicion çdo anëtarit të fondit me postë normale ose me postë elektronike brenda 10 ditëve pune nga miratimi. Brenda 30 ditëve pune nga dita e njoftimit të anëtarëve dhe publikimit të njoftimit, çdo anëtar i fondit mund të kërkojë ndryshimin e fondit të pensionit pa paguar komision transferimi.

Prospekti i fondit shoqërohet nga kontrata e anëtarësimit dhe deklarata e pranimit të pjesëmarrjes në fond. Shoqëria administruese i dorëzon prospektin secilit anëtar të fondit me kërkesën e tij, pa kosto.